

**GAQO
MANI**

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8 SH - 32

M 27

PRTTA NE SHPELLË

tregime

8SH-32

M 27

GAQO
MANI

PRITA
SHTË
SHPELLE



TREGIME

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NJERIU ME FENER

Një mbrëmje, në buzë të vjeshtës, Lazi u kthyesh shtëpi i pikelluar. Përpara se të shkonte në shtëpi, kishte bredhur, u kishte ardhur rrrotull stallave, kishte kërkuar në fshat, kishte dalë në fushë e që kthyer përsëri te stalla. Por mundimi i kishte vajtur kota, shpresat po i shuheshin dhe shqetësimi sa vinte i rritej e po e brente.

«C'më gjeti mua kështu? Bobo, si mund ta bëjë njériu me mend në kokë këtë punë? Bobo ç'vajta bëra».

Lëmshe hidhërimi i qenë mbledhur në fyt e në krahëror, trupi i dridhej nga inati dhe padurimi po e haqte si një përbindësh. Flaku tutje batanijen, brofi dhe hapi dritaren. Ajër i vakët u rrokullis brenda në dhomë dhe ai mori frymë me të gjithë mushkëritë. Përjashta gjithçka flinte dhe një errësirë e zezë, tepër e zezë, kishte pllakosur mbi fshat. Lazi ndenji një copë herë në dritare duke mbajtur sytë në errësirën e natës.

«Sa keq! Këtë punë s'duhej ta bëja, jo, s'duhej ta bëja! Venë më japid edhe fletënderi!... Po nesër ç'do të thonë vallë? Messiguri nesër që pa u gdhirë, fjala do të marrë dhenëp dhe mua do të më tregojnë me gisht!»

U vesh shpejt, si atëherë kur çohemi nga zëri i borisë së alarmit, rrëmbeu fenerin e latoshkën e vogël dhe doli.

«Shko thyej qafën tani, doemos, kur dëgjove mendjen e Bejkos, o derdimen... Hajde, hajde, ç'më bëre, o Bejko!»

Nata qe pus, pa yje e pa hënë. Lazi s'kishte parë natë më të zezë se ajo. Edhe kur kishin fjetur në mal, sa e sa herë, s'i kishte rastisur të shikonte natë më të zezë. Sapo doli u përplas pas lesës së gardhit. U mat të ndizte fenerin, por nuk iu duk me vend, nuk desh të binte në sy, i vinte turp! Eci ashtu nëpër errësirë rrugicave. Heshtja ishte e plotë e këtë hesh-tje sikur e thellonte edhe errësira, aq sa të dukej sikur fshati nuk kishte njeri, sikur e kishin braktisur. Për çudi edhe qenve e gjelave u qe kyçur goja.

Pas pak e la fshatin prapa e doli në fushë. Di-haste. Diku u ul më gjunjë e ndezi fenerin. Drita e fenerit sikur i dha një farë ngushëllimi, ajo drítë, e vëtmja drítë e mekur dhe e vagët në mes të fushës, dukej si një yll i këputur që po binte. Tek e ndiente veten fillikat në mes të fushës së zezë dhe memece, drita e fenerit i jepte kurajë, e kishte si shok. Me fenerin ngushëlløhej, tek ai i kishte varur tërë shpresat dhe ndërsa vazhdonte të ecte, rikujtonte udhën nga kishin zbritur, rikujtonte shtigjet e lëndinat ku kishin kullotur atë ditë.

«Ku do të ketë mbetur qengji vallë, mos e kanë gënjer ato «Lëndinat e qullta»?»

Sa ia ngrohu zemrën ky përfytyrim. Po ky qe vetëm një çast e bariu kridhet përsëri në mendimet torturuese. Ai ia ka frikën egërsirave, greminave... Dhë qengji qe i butë, i brishtë... Tani i qe mbushur mendja se gabimi që kishte bërë qe i pafalshëm.

«Duhej t'i kisha thirrur mendjes menjéherë, të isha kthyer apo e pikasa... Èshtë qengj race. Shteti shpenzon pér të përmirësuar racën, kurse unë...»

Dhe i vinte inat sa ta hante të gjallë atë Bejkon që ia ktheu mendjen e se la të nisej menjéherë. Po të mos e kishte dëgjuar Bejkon qengji tanë me siguri do të qe në stallë, me t'ëmën.

— S'më del një, o Bejko, — i tha Lazi shokut kur i futën dhëntë në vathë e i numëruan.

— Numëroi mirë, — mërmëriti Bejkoja duke kruar zverkun me kokën e krrabës.

— I kam numëruar dy herë, po nuk më del një...

— Dale bre, — kërceu Bejkoja duke flakur gunën e zuri t'i numëronte vetë.

— Hm! — tha, — mirë e paske ti.

Lazi u zverdh e u përcoll.

— Hajt, mos u bëj merak, do ta gjejmë nesër, s'ka ku të vejë ai, ja, u gdhi dita.

— Ta lëmë në mal??!

— E ç'do ta gjejë, o? Se mos një herë më kanë mbetur bagëtia në mal mua? Nuk e gjen gjë. Ka ca vjet, më mbeti një dele, ja, si sot, pa qe edhe barsë, po do ti, të nesërmen e gjeta me gjithë qengj. E kishët pjellë m'u në një zgërbonjë!

— Po sikur t'i bjerë ujku?

— Nuk mban egërsira kjo ana jonë tanë, — shtoi Bejkoja i sigurt e duke hedhur gunën krahëve.

— Nuk dihet ajo punë, o Bejko.

— E po s'u bë kokë njeriu, o derëbardhë.

Lazi e pa Bejkon me dyshim, por atë çast goja iu zu e nga që qe i lodhur s'nguli këmbë. U kthyen në shtëpi.

Koka i ziente dhe fjalët e dyshimta të Bejkos i

analizoi një për një; rropatej dhe i vinte çudi nga ajo moskokëçarje e bariut plak.

«Të jetë e vërtetë se mali jonë nuk mban egër-sira? Vërtet do ta gjej qengjin?»

Në ato çaste të një lufte të brendshme, midis ndërgjegjes dhe së vërtetës, diçka iu kujtua. Ajo ngjarje i qe skalitur në kujtesë. Histori e vjetër, atëherë, kur u ngrit kooperativa... Ja para sysh i doli Bejkoja i cili jo vetëm që s'desh të hynte në kooperativë, por llapte, shpifte kundër kooperativës dhe mundohej t'ua mbushte mendjen fshatarëve që të mos hynin se do të merrnin veten më qafë! Por atëherë s'ia vari njeri torbën Bejkos, entuziazmi pat qenë i madh dhe kooperativa u ngrit. Bejkoja, si mbe-ti vetëm, pa ç'pa, më në fund pranoi se qe treguar kokëtrashë dhe u lut ta futnin edhe atë në kooperativë. Në fillim ishin ca burra që s'donin ta pranonin. Bile, iu kujtua si të kishte ngjarë dje se si ia kishte përplasur surratit, m'u në mbledhjen e fshatit, Çeçoja, një burrë i moshuar:

— Ha ato që ke vënë mënjanë, për ty s'ka nevojë kooperativa, as që kemi parë ndonjëherë prokopi nga ty ne të varfërit. Hiç, ore mos e futni, — kishte ngulur këmbë ai.

Por Bejkon e, kishin përkrahur ca burra që nuk thelloheshin, ca të tjera thanë se e kishte kuptuar gabimin, se vërtet atë përshtypje të krijonte tek e shihje që lutej ashtu, dhe tek thoshte se ishte i gatshëm t'i dorëzonte kooperativës çdo gjë që do t'i kërkonte.

Lazi s'e ka harruar këtë ngjarje dhe sa herë që i bie ndërmend, tund kokën me dyshim. «Po, qysh dëgjova fjalët e tij dhe lashë qëngjin në pyll?»

Donte të hante veten me dhëmbë nga mendje-lehtësia e tij.

Të gjitha këto i kujtonte në të përpjatat e malit, e Bejkoja nuk i hiqej nga mendja, përfytyrimi i bariut plak i përziej me përfytyrimin e qëngjit.

Lazi çante errësirën duke dihatur. Trupi i tij i lehte, me shpatulla të gjera si të atletit, hapi i tij i sigurt e i shpejtë çante errësirën dhe i ngjitej malit si ndonjë sorkadhe. Lazi e kishte marrë me qejf të madh punën e bariut; e gëzonte grigja, i jepnin jetë blegërimat e buta të qengjave, e dehte ajri i maleve e aroma e barit të kullotave, ashtu siç e gëzonte edhe Dafina, fqinja, që ka zënë ta vështrojë me kërshëri e t'i hedhë romuze. Po çfarë do t'i thotë Dafinës kur ta marrë vesh? Lazi rënroi dhe i ra kokës me grusht!

Kohë më parë, ajo i kthente shpinën e skuqeji, tanj jo, tanj qëllon që takohen e këmbejnë ndonjë fjalë, qeshin, dhe Lazi e ndien se ajo vajzë diçka i gudulis brenda në krahëror. Po nesër ç'do t'i thotë, si do t'i dalë përpara?!

«Jo, ore Bejko, ti s'ke të drejtë, ma hodhe, më vure në gjumë, po unë do ta gjej qengjin, do ta kërkoj gjersa ta gjej. S'e le të ma çajë ujku, jo!»

Fjala e fundit e bëri të dridhej. U dha këmbëve e u mëshoi gjunjëve në të përpjatat plot dredha. Feneri tundej e dridhej sipas hapit të bariut duke shpuar errësirën. Kishte mbërritur te «Lëndinat e qullta». La fenerin përdhë e u mbush me frymë por ca drithërima të lehta e mbërthyen. Frynte erë e ai që djersitur. Atje i kishin kullotur dhentë, ndjehej era e bajgave. Çudi, Bejkoja nuk i hiqej nga mendja. Brofi, bëri disa hapa më tej duke fshirë ballin me kurrizin e pëllëmbës dhe ndolli një copë herë. I

ra poshtë e lart luadhit duke zgjatur fenerin përpara. Pak më tutje qenë ca shkurre e ca murriza, i tra-
zoi me dorë, por asgjë, asnë blegërimë, asnë she-
një.

«Jo nuk rri gjatë qengji në një vend, ai ka bre-
dhur, duhet kërkuar, mali ka shtigje, ka dredha,
skuta, rripa, ka lirishtet me bar të njomë e të ëmbël...
Diku do të jetë qengji, s'mund të ketë hyrë në dhe,
as ka fluturuar në qiell!»

Lazi mori një monopat e qëndroi majë një skute
që dilte si gungë në majë të malit. Në sukë era bë-
hej më e fortë. Bariut iu kujtua se si në atë sukë,
retë zgresin fare poshtë e lëvizin ngadalë sikur lë-
pijnë faqet e shkëmbinjve dhe gjethet e dushqeve.
Iu kujtua se si kur zbret reja ia përhumb tufën pér
një çast, e si delet dalin përsëri në shesh kur retë
ngrihen lart ose shtyhen më tutje.

E përfytyronte shumë qartë ditën e shkuar dhe
megjithëse ato vende i njihte me pëllëmbë e kishte
të vështirë ecjen përpara. «Këtu mund të gremisesh,
është rrëzomë!» Nga balli i pikonte djersa, fytyrën e
mbante përpara dhe veshët bigë se mos dëgjonte
ndonjë zë. Në një farë vendi, tatëpjeta bëhej thikë e
në të majtë qe një grykë pérroi. Ai ia kishte frikën
pérroit. Ai përrua i fjetur gjithnjë mbante rreziqe
me vete, sepse kur binte shi ai ngjallej papritur e
gurgullonte me lemeri. Dhe Lazit i vinte keq pér
qengjin, i dukej sikur e kishte vrarë me dorën e tij.
Padashur shtrëngonte latoshkën dhe e ngrinte lart.
Ajo qe arma e tij e vetme.

Në sukë s'kishte ç'të kërkonte më. As ditën nuk
do ta shkelte aq mirë, prandaj vendosi të zgresë po-
shtë, të kontrollojë pérroin, por pikërisht, zbritjen
nuk dinte nga ta niste. Sepse po i mbushej mendja

se mbeturinat e qengjit do t'i gjente në përrua! Mori nga e majta një rrugë më të gjatë, atë që njihet më mirë dhe filloj të zgresë këmbë e duar, kur befas, ranë pikat e para të shiut. Një gjëmim i largët u përhap dhe mbushi sukën e përroin me jehonë. Fshiu ballin, u ndal e përgjoi. Iu bë sikur dëgjoi një farë blegërime të zvargur e të përmbytur. Ndolli, por jo, asgjë, i kishin bërë veshët. Përsëri ndolli e thirri me atë gjuhën baritore që dhentë e njohin aq mirë, por përsëri, përveç jehonës së zërit të tij që u tret në errësirë, apo e përpiu era që frynte pa pushim, dhe e shohti te përroi, asgjë.

Ca pika të mëdha e të dendura shiu ia lagën fytren, pastaj befas, sikur të hapej një mazgallë e stërmadhe, shpërtheu një rebesh i vërtetë. Një shkrepitimë e fuqishme llamburiti dhe e bëri vendin ditë, por pas shkrepitës, errësira u bë edhe më e zezë, edhe më e thellë, ndërsa feneri mezi ia ndriçonte hapin. Lazi s'kishte ku të fuste kokën, vetëm po të arrinte te përroi mund të gjente ndonjë strehë.

«Tani do ta ketë pisk qengji. Në ka shpëtuar gjallë, tani do të mbytet në shi e në llucë. Eh, o Bejko ç'bëra që të dëgjova!»

Bariu fryu ujin nga buzët e mes për mes pell-gjeve, çante përpara.

«Po të mos jetë as te përroi, s'kam për ta gjetur, më! Zbrit tani, thyhej kokën... Shkel mirë, kontrollo vendin se u gremise dhe nesër do të vinë të të kërkojnë ty!... Hajt përpara, tani është vonë, s'kthehet dot», — e torturonin mendimet bariun. Shiu breronte dhe ai mendonte qengjin, Bejkon... Ca kujtime të largëta, ca si pëshpërima, e ndiqnin hap pas hapi, e i vezullonin herë pas here në kujtesë.

«Ja, aty poshtë, te bari i njomë i përroit ngri-

nim leqe për thëllëza dhe s'kishte javë që të mos znim. Në pyll kishte verdhashë e mëllenja por ato s'rrojnë në kafaze.... Po qengji...».

Nxiton hapin e s'pushon së ndjelluri, por sa më tepër që zbret, aq më i pafuqishëm bëhet zëri, se edhe pérroi ka filluar të gurgullojë me zhurmë. Përrroi buçet e fershëllen ndërsa drita e fenerit luhatet dhe shuhet. «Edhe kjo u desh tani, që dreqi e mori» dhe kërkon shkrepsen nëpër xhepa. I vjen për të qarë, e ndien veten të mundur. «Mbaroi qengji, humbi, u zhduk. E mora më qafë... Eh i shkreti, eh, o Bejko, vajta mora mendjen tënde.»

Bariu hyri nën një shkëmb që dilte si strehë. Drita e fenerit u luhat po s'u shua. Errësira rreth e rrotull ishte kërcënuese. S'dinte ç'të bënte, nga du-hej të kërkonte.

Mbështeti kokën te faqja e ftohtë e shkëmbit ndërsa shiu vazhdonte të binte i trashë, si litar, e pushim. Bënte ftohtë dhe ai ishte qullur gjer në koskë. Retë shtrydhnin njëra-tjetërën dhe në qiell, aty-këtu, vizatoheshin arabeska flakërimash të verdha e të blerta. Në pellgjet e ujit, nga drita e shkreptimës, sajoheshin figura të çuditshme, të frikshme, shikonte hijen e vet të deformuar, shikonte shkëmbinj me forma kafshësh, ca të stërgjatura, ca të shtypura e të fryra. Me zor u shkëput nga ai vegim torturues, pjellë e trazirës shpirtërore, doli nga streha dhe ndjeu shiun e ftohtë drejt e në mish. Mendimi se qengjin e kishte humbur e bënte si të marrë. Po të ishte vrarë qengji, ai do të kishte bërë të pamundurën përtë shpëtar, ndërsa mbrëmë e vau me duart e tija... Ndolli përsëri, duke hequr këmbët zvarrë në një llucë balte. Bëri përpara me shpresë fare të humbura. Nuk mund ta hqite mendjen nga qengji, e kishte vrarë me

dorën e tij, kishte vajtur e kishte marrë mendjen e atij njeriu të pacipë; kishte ardhur çasti kur i kishte thirrur ndërgjegjja, por qe tepër vonë, Gabimi qe bërë dhe s'kishte pér t'u ndrequr më; «Këtë s'kam pér ta harruar, u bëra shkaktar, vrava qengjin!»

Dikur, në shkollë, kishte ngordhur një lepur se pse njéri i kishte dhënë, pa ditur, bar të spërkatur me helm. Ishte bërë potere e madhe midis nxënësve. Lazi, i pari, e kishte kërcënuar shkaktarin... Shtrëngoi tëmthat kur papritur iu bë se dëgjoi një zë të dridhshëm; një zë që i ngjante blegërimës, një zë të butë që i ngjethi mishin. Një valë e nxehët ia pushtoi trupin vetëtimthi, sikur të kishte hyrë në një dhomë të nxehët. Mbajti vesh. Shiu derdhej pa pushim. Gjithçka përreth kullonte ujë dhe toka qe ngopur me ujë e nuk pinte më. Bariu me sy të çapluar e veshët bigë s'dinte nga t'ia mbante!

— B e e e e!
Lazi shtangu.

— B e e e e!
— Qengji, — thirri e u lëshua përpara.

Lazi e thirri, ndolli, trazoi me duar gurët, pell-gjet, llucën gjersa më në fund pushtoi me krahë një send të butë e të qullët.

Bejkoja, kishte pritur ndonjë gjysmë ore te statllat por Lazi nuk po dukej. Megjithëse qe errët akoma, ai diçka nuhati, tundi kokën me dyshim e s'e bëri të gjatë, po u nis drejt e në shtëpi të Lazit. Ba-

riu plak gulçonte e trokiste nëpër dyert e shokëve të kryesisë duke dhënë alarmin:

— S'është Lazi ore, do të ketë mbetur në mal, pas qengjit, kështu na ngjau...

Bejkoja ndiente një farë kënaqësie për atë gjurulldi që po pushtonte fshatin. Njerëzit shqetësoheshin, nduknin Bejkon nga guna, e pyesnin, por ai me ca fjalë të thata, ua tregonte shpejt e shpejt:

— Më thotë kjo rradake se ka vajtur të kërkojë qengjin!

Dhe gulçonte, me një gulçimë të shtirë, sepse po ta vije re me kujdes dalloje kënaqësinë e njeriut të keq.

Njerëzit vraponin në të përpjetën e dhiaras së malit me atë shqetësim të natyrshëm që pushton shokun për shokun. Vrapuan. Në një farë vendi qëndruan. Kryetari diçka i pëshpëriti sekretarit të Partisë, pastaj iu drejtuan Bejkos:

— Mbrëmë, tërë natën bëre gjumë rehat-rehat, ore Bejko, si t'ia vëmë emrin kësaj, bre?!

Bejkoja u zu ngushtë nga ajo pyetje që s'e priste. Kapsalliti sytë, fshiu mustaqet e tundi kokën. Ai mendonte se e kishte larë veten, se fundja, ai e kishte dhënë alarmin i pari, bile ata duhej t'i rrithnin shpatullat. Lazit, ja atij, duhej t'ia hiqnin veshët për atë marrëzi që kishte bërë. Po fjalët e sekretarit dhe ai shikimi i vëmendshëm e shpues i kryetarit të kooperativës ia trulloën kokën dhe aty për aty e humbi pusullen.

— S'të hëngri ca meraku ty? — vazhdoi kryetari.

Bejkos iu rëndua trupi, guna i qe bërë plumb mbi shpatulla e krraba i dridhej në dorë.

Lazi, qëndroi te «Lëndinat e qullta» e u mundua tē ndezë zjarr, por kokat e shkrepseve ishin lagur. C'të bënte? Këmbët i digjnин, trupi i mardhur i dhimbte, por këto s'ishin asgjë, përpara atij gëzimi aq tē madh. Ndjehej i lumtur. Ja, edhe qengji. Bariu psħeretiu dhe shtrëngoi grushtin:

«S'ka qëllime tē mira ai njeri, duhen hapur sytē, i do ćjerrë maska... Kaq ka nē dorë kaq bën!» I rrīh-nin mendimet si ćekan nē kokë, kur befas dëgjoi një zë. E thërrisin me emér. Lazi brofi, vuri pëllëmbët përpara gojës e thirri:

— E e e j !

Mbi «Lëndinat e qullta» kishte rënë dielli, një diell i madh e i ndritshém si kurrë ndonjéherë. Dhe

qielli atë ditë ishte më transparent se kurrë. Përpara, drejt tij pa disa njerëz. Të parin njobu Bejkon. Befas iu mbloħi një grusht nē fyt. I qe mbushur mendja se ai njeri qe i keq, armik, dhe nuk mund ta shikonte as me sy. Nē mes tē atij grupi njerëzish Lazi dalloi edhe Dafinën. Nuk e priste. U skuq. Vajza rendi, e mori qengjin nē duar dhe shikimin e èmbel tē syve tē saj e hodhi mbi Lazin.

Lazi u mbush me frymë. Hutimi që i ngjalli shikimi dhe buzëqeshja e Dafinës, iu shkri aty pér aty, gjoksi i gufoi dhe befas iu vërsul Bejkos:

— Ndonjë ditë do ta lësh térë tufén nē mal e s'do ta bësh qejfin qeder, moj dhelpra plakë.

— Avash, biro, s'të kam ndonjë faj unë, — belbëzoi Bejkoja.

Lazi shtrëngoi dhëmbët, grushtet e u kthyesh nga të tjerët:

— Ma hodhi armiku kësaj radhe, u tregova leshko, po këtë që bëra do ta shlyej, o shokë, do ta shlyej me punë...

Bejkoja kishte ngrirë përpara Lazit. Ai nuk e gjente dot zërin, jo, i qe qepur goja. Vetëm atë çast e ndjeu se i kishte ardhur fundi. I dha fuqi vetes, desh të bënte përpjekjen e fundit, rrrotulloi sytë e hodhi ca shikime të mjegullta mbi njerëzit që e rrethonin, por më mirë të mos e kishte bërë atë përpjekje. U tmerrua e iu morën këmbët. Nga fytyrat e njerëzve kuptoi se gjithçka kishte marrë fund njëherë e përgjithmonë. Iu bë se dëgjoi dhjetëra zëra, ato ngjiteshin nga fshati, dilnin nga «Lëndinat e qullta», zbrisnin nga suka duke thirrur: Armik, armik!

Rrëketë kallonin akoma ujë, pikat e shiut, që ende s'qenë shkundur e avulluar nga petalet, dëllinjat e murrizat, shkëlqenin. Dielli vjeshtak i kuq, si një disk i zjarrtë, derdh mbi to dritën e verdhë. Lazi hodhi sytë nga suka, nga përrroi i turbullt, nga pylli, vështroi shkëmbinjtë, kaçubet e shpatet hijerënda që të larë nga shiu vezullonin, e psherëtiu i lehtësuar. Dafina lëshoi qengjin. Blegërima e tij sikur e solli në vete Lazin. Ngriti kokën e ndeshi shikimin vjedharak të Dafinës.

NJË DITË DIMRI

Ia kisha hipur doriut tim këmbëshpejtë dhe po çaja dëborën, mes për mes asaj udhishteje të ngushtë që të nxjerr nga fshati. Dëbora binte me furi, e imët dhe e akullt. Flokët e saj të godisnin si me saqmë ftyrën. Era ulerinte dhe e gjithë fusha dukej e përmbytur nga një bardhësi e pafundme, e akullt, e heshtur. Në rrugë nuk kishte asnje gjurmë. Edhe gjurmët e doriut i mbulonte tufani, aty për aty. Kafsha mezi ecte dhe shfrynte avull nga hundët, po unë ia kisha mbërthyer thembrat në bark dhe e nxitja pa pushim.

Po i afrohesha postbllokut. Posta ku rrinin gjermanët, një kasolle e ulët, filloj të shquhej si një këubë e bardhë zhytur në atë sfond vezullues. E kisha parë sa e sa herë atë kasolle, por kësaj radhe se si më dukej... Pas pak dallova edhe trarin lyer me ato shiritat bardhë e kuq dhe, më në fund, rojen që bënte ec e jakë matanë tij.

— Hya, dori, — shpova kalin me thembra, kur një zë thirri:

— Ndal!

Tërhoqa kalin për kapistre dhe zbrita. Roja rrinte prapa trarit, i mbështjellë kokë e veshë me një shall të kuq prej leshi. Pushkën e shtrëngonte me të

dy duart, të veshura edhe ato me doreza leshi, ndërsa kapota e gjatë i vinte gjer te noçkat e këmbëve. Po, megjithëse ishte veshur mirë, dridhej si purtekë dhe maya e hundës i qe mavijosur. Bëri me dorë që t'i afrohesha dhe ngriti trarin.

- Ku vete, more jezit?
- Në mulli, zoti xhandar.
- Oj! S'paski mulli andej?
- Kishim, si s'kishim, po i ra gjylja dhe e she-shoi!

— Oj! Pa lidhe kalin dhe hyrë atje njëherë. Atë çast, nga kasollja doli një xhandar tjetër me një fytyrë të zyntë e me ca sy të bardhë e të ftohtë si qelqi. Ai më hetoi një copë herë pastaj bërtiti:

- Të pjellët të paska zënë, o morracak, që të vish e të na bezdisësh në këtë të ftohtë?
- Nga halli, zoti reshter! S'kemi një thërrime bukë në shtëpi.
- Po ne, ç'kusur kemi o, që, më të rëntë rrufeja,
- e duke më tërhequr përmëngë më futi në kasolle.
- Afshi i ngrohtë, era e qelbur e duhanit gérxhall dhe e rakisë së mbajtur në kacekë vaji, më ranë përnjëherësh në kokë dhe më sollën të përzierë, por pas disa çasteve u mësova e fillova ta ndiej të ngrohtin në fytyrë, në trup e të më vijë mirë.

Kasollja kishte një të ndarë të vogël, fare të vogël dhe ngrohej nga një stufë e madhe, e sajuar prej një fuçie karburanti e me ca qyngje të shtypur e të çarë, vrimat e të cilëve i kishin zënë me baltë. Po kishin mbetur akoma plasa nëpërmjet të cilave flakët e purpurta nxirrin gjuhën dhe tymi që shfrynte me tërsëllëm sa herë që egërsohej era mbështillte dhomën. Stufa digjte dru për lemeri, përlante trungje të


tërë aty për aty, si një lubi dhe atje brenda e harroje dimrin.

Dhoma kishte dy dritare të vogla, tamam si frëngjji, një shtrat prej hekuri, një tavolinë të vogël e mbi të një telefon të vjetër me manivelë dhe një llambë gazi të varur në mur. Një pushkë e gjatë ishte lënë në këmbë, në një qoshe. Në faqen e murit përballë qe një si dollap. Që andej vinin zëra, dëgjoheshin biseda në gjuhë të huaj.

Reshteri hapi dollapin dhe seç foli në gjermanisht. Dëgjova një të qeshur, pastaj një britmë, kur befas reshteri mbylli kanatën. Ai s'donte ta bënte veten, por u mor vesh se ai të cilit iu drejtua e kishte sharë. Filloi menjëherë të më pyesë:

- Hë, more lanet, pa më thuaj ku vete?
- Në nulli, të bluaj misër, kemi mbetur pa bukë.
- Hm... Po për komunistët kini?
- Ne s'jemi me komunistët... Ata u shuan, i fshiu operacioni.
- Ua! Kush t'i ka mësuar këto fjalë ty.
- Naaa, u bënë, këmbë s'mbeti.
- Kush të zë besë ty, bre, po hajde fol, ku vete?
- Në nulli, të betohem, për flamurin.
- Dëgjo këtu. Fol me të mirë... Ku vete, kush të dërgoi këtej, përsë të dërgoi...
- Ç'të të them, zoti reshter.

Rripi i mesit fërshëlleu një herë mbi shpinën tim, pastaj filloi radhë. Reshteri e hapte krahun aq sa i arrinte, rripi bënte «fësht-fësht» mbi trupin tim dhe unë mundoheshë të mbrohesha, por më kot, rripi më arrinte, më ngjitej në mish, më kafshonte. Një valë e nxeh të dhe një zhurmë e fortë më buçiste në kokë, në veshë. Reshteri bërtiste dhe jargët e tij pushonin mbi mua. Të sharat e tij qenë në dyra dhe goditjet e



atij rripi të mallkuar prej lëkure të fortë qenë të hidhura. «Ata do të të kërcënojnë, mund edhe të të rrahin, se kohët e fundit janë bërë si të luajtur nga mëntë», sillja ndër mend fjalët e Sadikut, po ama dhe fjalët e gjyshit kur më përçollti, «Puna është të kaloj matanë, pa një pa dy», më bënин tē mposhtja dhembjen.

Befas u hap porta. Një xhandar tjetër solli qeset me misër dhe i zbrazi në truall. Isha fare i trullosur. Mishi më digje. Fjalët e Sadikut e të gjyshit më ushtonin në veshë, ndërsa reshteri po përhapte misrin me këmbë sa andej, këtej.

— Misër është zoti reshter, — fola më tepër përtë provuar në kisha ende fuqi.

— Ti mos më mëso mua, — hungëroi reshteri dhe hapi sërisht kanatën në faqen e murit.

Pas një çasti hyri një oficer i gjatë e i hollë si staf. Kishte një hundë të madhe e të shtypur si të një boksieri, një ballë të gjerë dhe një mjekër katërqoshe. Fytyrën e kishte të mbushur me prenjka. Vëtëm sytë nuk ia shqova që në fillim sepse i mbante pothuajse mbyllur. Më pyeti menjëherë sapo hyri. Reshteri përkthente:

- Sa vjeç je?
- Pesëmbëdhjetë.
- Emrin?
- Gjeli Mitro.
- Çfarë ke me vete?
- Misër.

Gjermani hapi sytë një sekondë dhe i mbylli përsëri, pastaj u ul mbi buzën e tavolinës dhe diçka foli.

- Zhvishu, — klithi reshteri.

Mbeta në të mbathura. Një e ftohtë e hidhur fi-

lloj të ma pickojë mishin kudo. Jashtë tufani qe egërsuar dhe qyngjet shfrynin me duf flakë e tym. Sytë më digjnin. Kasollja po mbytej në tym. Reshteri kontrollonte teshat. Pantallonat i kishin flakur tej. Kopsat ushtarake zbardhnin, zemra më rrihte.

— Mërdhiva, zoti reshter.

Gjermani hoqi sytë nga xhaketa për një çast dhe më zhibroi me një shikim të egër. Reshteri flaku xhaketën dhe mori pantallonat. Ngriva në vend. Një e nxehtë po më digje përbrenda. Goja më qe tharë. Kopsat e pantallonave zbardhnin, ato ishin atje, unë e kisha mendjen te ato, vetëm te ato. Dhe përsëri fjalët e Sadikut, komisarit të zonës: «Është shumë sekret dhe duhet t'ia dorëzosh Vasilit në dorë, vetëm atij. Po të mos jetë në mulli prit sa të kthehet.»

Një copë herë vrava mendjen: «Përse më nisi nëpërmjet postbllokut? Edhe shumë sekret edhe në postbllok, në gojën e ujkut, si capi te kasapi... Por ai kishte të drejtë. Zona patrullohej nga armiku dhe po të më zinin do të dyshonin. Ndërsa kështu në postbllok ballë për ballë...»

Reshteri kontrollonte pantallonat. Gishtat e tij të lyrosur e të nxirë, pa mish, tërë nyje, lëviznin mbi pantalonat si krimba dheu, trazonin, shqepnin. Mua më gufone zemra, më rrihte gjaku, më digje mish. Një gulçimë e mbytur po ma shkallmonte krahërorin. Ajo që ishte tepër sekret, ishte atje, në duart e reshterit, përparrë oficerit trupgjatë. Ajo qe gjithçka, atë e kërkonte armiku, atë e priste Vasili.

Çfarë mund të qe shkruar në atë letër? Gjithçka mund të ishte shkruar. Sikur ta dija. Mbi ballë më kishin mbirë bula djerse. Po sikur ta gjente... Kjo do të qe fundi dhe atëherë q'do të më mbetej mua, q'do t'i thosha Sadikut, si do t'i dilja përparrë gjyshit,

ç'do të mendonte për mua Vasili. Befas reshteri flaku pantallonat dhe mori opingat. Për pak më shpëtoi një klithmë gjëzimi kur gjermani më kapi për flokësh. Ai i hapi sytë ngadalë dhe unë pashë një palë sy të kuq, si të gjarprit.

— Partizan, — bërtiti.

Unë mohova me kokë. Ai vuri dorën mbi revole.

— Komunist?

— Nacionalist, — iu përgjigja. Por reshteri, që me sa duket e dinte se në fshatin tonë s'kishte asnje bllist, ma veshi me pëllëmbë fytyrës.

— E sheh që gënjen!

Gjaku i ngrontë më skuqi hundët. Ai u mat të më binte përsëri por gjermani kishte nxjerrë revolen. Tyta e ftohtë më preku lëkurën mbi zemër, pastaj témthat, buzët, ballin. Sytë e kuq ndritnin si thëngjij, tyta e parabelit shëtiste mbi trupin tim e ftohtë, e ngurtë, e pamëshirshme. Ajo mbante vdekjen, m'u në majë dhe e shëtiste mbi trupin tim. Shikimi më kishte ngrirë mbi fytyrën si kafkë të gjermanit sykuq, që befas ngriti dorën dhe e lëshoi më sa fuqi që kishte mbi zverkun tim.

Kur erdha në vete, pashë reshterin, që po pështynte me potëre mbi llamarinën e skuqur të stufës, e pashë se si e ngriti pagurin me raki, dhe më në fund dëgjova një fjalë:

— Shporru tan!

Aq i pastër e aq i ëmbël ishte ajri jashtë kasolles sa ndjehesha si i dehur. Doriu kërcente nëpër dëborë dhe shfrynte avull. Vështroja rrrobat se si m'i kishin shqyer e i kishin bërë fërtele. Dëbora vazhdonte të

binte me furi; e akullt, e kristaltë. Që tutje, thellë fu-
shës, vintë një potere e cila herë i ngjante zhurmës së
një automobili, herë thundrave të kuajve. Ndala dor-
riun dhe vura veshin. Jo, s'kishte asnë lëvizje, ishte
vetëm doriu im që shkelte mbi dëborë ndërsa mua më
buçisnin veshët.

Pas pak fillova të ndiej përsëri të ftohtë, por një
të ftohtë të hidhur që të mpin, që të vë në gjumë e
të vdes. Kishte momente kur e ndieja veten si në një
nanurisje të ëmbël, të gjatë, të pambaruar. Ah, sa ua
kisha frikën çasteve të tilla. Këto çaste janë tinzare,
të pabesa.

Befas përpara dallova konture shtëpish, mulla-
rësh e pemësh pastaj për habi ato pamje m'u vagë-
lluan. Pastaj përsëri më doli fare qartë e përsëri m'u
zhdukën sikur i rrëmbente e i përbyste stuhia. Kthe-
va kokën prapa. Asgjë, veç heshtjes, bërdhësisë dhe
thëllimit. Ja edhe mulliri aty mënjanë si një këpur-
dhë. Te portat e mbuluan përgjysmë me dëborë, cik-
lonë e ngrinte bërën përpjetë si një shtëllungë leshi.
Jazi qepbërë kallkanë dhe mulliri dukej si një kalibë
stani e braktisur. Përnjë çast mendova se mos vërtet
e kishin braktisur por dyshimet kaluan shpejt. Oxha-
ku nxirrte tym. Trokita në portë. Heshtje. Trokita më
fort. Përsëri heshtje.

O mullis... O xha Tili!
Kush është, iu dëgjuar një zë i qetë e i pa-
njohur.

— A bluan, o xha Tili, — fola me një mendim të
turbullt në kokë.

Luajti llozi i portës, kanata u tund dhe te porta
u duk një xhandar! U ngurosa. Fjala më ngeci në gry-
kë. S'dija si të bëja. Kaq e pati kjo punë mendova,
ata të postbllokut ma paskan punuar bukur.

Mendja po më fluturonte. Mülliri kishte rënë në dorën e tyre, edhe Vasili ndofta, edhe xha Tili... Kështu edhe misioni im kishte dështuar. Ndofta letra që unë po sillja paralajméronte Vasilin, prandaj Sadiku më kishte thënë «Nxito, t'ia japësh Vasilit» Po unë s'kisha mbërritur në kohë, unë kisha dështuar dhe ai kishte rënë në dorë të armikut. Xhandari më vështron te ngultas.

— Përse erdhe këtu? — pyeti ai.

Vura dorën mbi qeset me misër se zëri s'më dilte nga gryka. Xhandari më hoqi për krahu; unë ngrita sytë, kur pashë xha Tilin që zgjati kokën në dritare.

Mullisi kishte një fytyrë të ngjallme e të bardhë, si atëherë kur bluante ashtu edhe kur nuk bluante. Sikur pahu i miellit i kishte hyrë nën lëkurë. Sytë e tij ishin të vëmendshëm, të qetë e të butë. Befas zemra m'u drodh.

— Hyrë brenda, o djale, — më thirri xha Tili.

Nga vështrimi i xha Tilit diçka nuhata, por përsëri mendimet i kisha të turbullta. Xhandari e lidhi kapistrën e kalit te njëra nga rrezet e hekurta që ishin ngulur në mur ndërsa xha Tili më futi brenda.

— Xhandarët! — pëshpërita.

— Janë shokët tanë.

Prapa hambarit pashë xhandarë të tjerë. Sytë më ishin veshur, ç'po bëhej ashtu, mos isha në ëndërr?

— Hajde, Gjeli, po të presim si ujin e ftohtë, — dëgjova zérin e Vasilit por unë s'po e mblidhja dot veten.

— Jemi tanët, mos shiko se janë veshur xhandarë, — foli përsëri Vasili.

Një si cërril uji të ngrohtë filloj të më zbresë mbi ballë, nëpër trup. Gymtyrët m'u çliruan nga ajo tendosje. U mbusha me frysme,

— Thashë se ishit vërtet armiq, — dhe shkula njërën nga kopsat e pantallonave, një kopsë nga ato ushtaraket që ndahen më dysh. Nxora biçakun, ia hapa buzët dhe hoqa letrën. Vasili e hapi me nxitim ndërsa të tjerët po qeshnin e po më rrihnin supet. U hoqa mënjanë, pranë një vatre me zjarr e ndërkohë dëgjoj zërin e Vasilit:

«Mbi njëqind gjermanë e ballistë, janë rrethuar në Pyllin e Zi. Forca të freskëta armike preqatiten t'u shkojnë në ndihmë. Misioni i armikut është kapja e spitalit partizan. Merrni masa për të mos lejuar ardhjen e ndihmave.»

Shokët zunë të vishnin kapotat e pa ngjishnin armët, ndërsa mua më fluturoi mendja te Pylli i Zi, te spitali partizan. Isha i lumtur.

LËKUNDJE

Rruja e gjatë e plot dredha futej si një pykë mës për mes shpatesh të kuqërrëmtë e të veshur me bush e me dushk. Nga shpatet, zbrisnin përrrenj të panumurt, të thatë, por që në vjeshtë e në dimër gjallë-roheshin e tërë ujin e shkarkonin mbi rrugë, duke sjellë gurë e fiçorë.

— Na prishin udhën këta, — bëri me kokë shoferi duke treguar një përrua me fiçorë të bardhë.

— E marr me mend se si vërshojnë në dimër.

— Do të të bjerë rasti t'i shikosh vetë...

Qesha e u mbusha me frymë. Ishte hera e parë që shkelja në këto anë, dhe nga kurioziteti, natyrisht, mbaja sytë të xhami i dritates. Autobusi, megjithëse ishte nga ata njëzet e pesë vendësh, rënkonte e dridhej në kthesat e në të përpjetat, dhe sikur po më ndillte gjumë. Disa i kishte zënë gjumi. Një çast i mylla sytë e mbështeta kokën te xhami i dritates.

— Fli, — tha shoferi, — kemi edhe një orë e gjysmë rrugë akoma.

Motori uturonte, zhurma e tij mbushte tërë autobusin dhe herë pas herë dëgjoheshin guriçkat që përplaseshin parafangove dhe mua më dukej sikur diçka thyhej nën makinë. Po me ato shqetësime u mësova shpejt dhe po nanurisesha midis gjumit e kujtimeve.

Njëherë thashë së më zuri gjumi, kur befas m'u shfaq përpara karpentieri, shoku im i punës. Sapo isha ndarë nga ai por sepse e ndieja akoma ngrrohtësinë e krahëve të tij që më pushtuan aq fort në agjenci. Nuk do ta harroj kurrë atë burrë dhe fjalët e tij të ciltra e të ngrrohta i ndieja se më ishin ngulur thellë në kujtesë. Për të do t'i tregoj edhe Mirjanës sepse edhe fjalët e tij më bënë të marr këtë vendim. Kur kujtoj se me çfarë tallazesh kam luftuar, më vjen çudi. Sa poshtë bie njeriu nganjëherë!

Mbylla sytë përsëri dhe mendja më brodhi larg, e kujtimet e freskëta më nduknin, s'më linin rehat.

— Inxhinier, e ke humbur fare, ke ca ditë? Mos je gjë sëmurë? Sëmurë do të jesh, se ju të rinjtë s'rrëfeni, — më tha atë ditë karpentieri.

— Nuk më dhëmb asgjë, veçse kam... — e fjala më ngeci në grykë.

Karpentieri më hodhi dorën në sup e më pa drejt e në sy.

— Edhe unë kam pasur halle kur kam qenë i ri, doemos njerëz jemi, ama kam pasur një të mirë: ç'kisha, ç'nuk kisha e ndaja me shokët.

Por unë s'pata guxim t'i hapja zemrën atij njeriu të mirë. Mendimet e mia më kishin pushtuar si me kthethra dhe s'kisha fuqi t'u bëja ballë. Atë ditë dola i trullosur nga zyra e me një ndjenjë të çuditshme zbrazëtire, i rashë drejt bulevardit «Skënderbej» pa e ditur fare se ku më shpinin këmbët. Që nga dita që Mirjana iku e zemëruar, kishte kaluar një javë dhe unë jo vetëm që s'po e harroja atë zënkë, por ditët që vinin më rëndonin. Sepse kisha bindjen se Mi-

rjana me të mbërritur në fshat, ku kishte dy vjet që punonte, do të më dërgonte letër apo telegram për të kërkuar falje dhe për të përkrahur mendimin tim. Po nuk ndodhi kështu siç kisha menduar unë. Ajo priste që unë të shkoja atje... Boulevardi ishte plot me njerëz ndërsa unë ecja i vetëm, i zhytur në pellgun e mendimeve të nxehtha. Pas shiut që kishte rënë natën e kaluar që freskuar dhe freskia e ëmbël e joshëse, që zbriste nga kodrat e pyllëzuara me akacie, bli e pishë, më hynte në trup. Toka qe ngopur me ujë, bimët ishin gjallëuar, ishin larë e përtërirë dhe ajo përtëritje shpërndante aroma dehëse trëndafilësh, blirësh e unapesh. Aromat më ndillnin, më ndillte edhe fërshëllima e lehtë, fare e lehtë, e pishave të parkut.

Sa herë që viaj këtu, më dukej sikur çlirohesha nga mendimet, por atë mbrëmje mendimet i kisha të turbullta e të nxehtha, ato më nduknin çdo pjesë të trupit. Isha ulur te një stol i gurtë, përpara shatrivanit dhe nuk e kisha kuptuar fare. Cërritja e ujit të shatrivanit më kujtonte diçka, kujtimet më shpaloseshin si fletët e një libri e sepse më dukej sikur në ato faqe lexoja me èndje e me frikë pjesë ngajeta ime, ato përziheshin me ndodhitë e fundit, me karpentierin, me Mirjanën e me Gencin.

... Atë buzëmbrëmje, kur i shfaqa dashurinë Mirjanës, ishim në një park, të qetë e të errët, me drurë të lartë e të zinj si ky. Diku, mbi degët e një shelgu lotues, dëgjonin flatrat e një kumrie apo qokthi. Unë ndieja frymëmarrjen e shpeshtuar të Mirjanës se si më pëershkonte fytyrën, ia shikoja edhe shkëlqimin e bebzave të syve se si shponin errësirën, pastaj e pushtovat me të dy krahët. Atë kohë ishim studentë dhe atë natë i dhamë fjalën njëri-tjetrit se do të martohenim e do të venim ku të na thërriste detyra.

* * *

Kishin kaluar dy vjet që kurse kishim marrë diplomat. Detyra na kishte ndarë nga njëri-tjetri, por nuk qemë mërzitur pasi ajo ndarje do të qe e përkohshme, ne do të bashkoheshim për gjithnjë sapo të merrja apartamentin. Po një javë përpëra se të merrja çelësin e hyrjes, Mirjana erdhi vetë dhe më tha se i kishin dhënë dhe asaj një apartament dhe kërkonte që të shkoja dhe unë atje. Në fillim s'u besova veshëve të mi, po tek pashë fytyrën e gëzuar të Mirjanës më pushtoi një inat i madh. Pastaj mendova se do të qe më mirë të mos e jepja veten dhe t'i ia ktheja mendjen me të mirë. Po qe e kotë, ajo kishte vendosur, pastaj kështu kishin vendosur dhe një grup shokësh e shoqesh të kursit tonë. Më numëroi emrat e tyre: Kostandini, Tatjana e Genci. Emri i fundit më hutoi. Ç'desh ajo që ma zuri në gojë kur e dinte që unë s'desha ta dëgjoja atë emër! Një ditë kur e pashë të shëtiste me Gencin, ne u zumë. Megjithëse kanë kaluar disa vjet, e kisha ende të gjallë. Një herë tjetër kërkova Mirjanën në shtëpi, po s'qe. E éma e saj nuk dinte se ku kishte vajtur. Nisa të shëtis pa qëllim, kalova nga bulevardi i madh, bëra një xhiro, u ktheva nga rruga e Dibrës, kisha për të marrë ca fotografi, kur papritur shikoj Mirjanën me Gencin tek po vinin drejt meje. Gencin e kishim pasur shok klase në vitin e parë, por ai e braktisi shkollën dhe tani punonte në një oficinë mekanike.

Për Gencin nuk kam pasur kurrë simpati, sepse më dukej njeri i qullët dhe egoist.

C'është e vërteta s'më erdhi mirë. Kisha besim te Mirjana, ajo ishte e singertë dhe nuk më fshihte

asgjë, por megjithatë, një hije dyshimi erdhi e u ndeh përpara meje.

— Ja, edhe Iliri, — tha Mirjana me gëzim.

Genci më shtriu dorën.

— Ku je, mo Ilir, si ia shpie, kam kohë që s'të kam parë.

Me të vërtetë ai njeri qe një qull i tërë, edhe pëllëmba e tij të ngjitej, edhe ftyra e tij të dukej si prej brumi, edhe ai interesim që tregoi për mua, m'u duk artificial. Bëra buzën në gaz me pahir e i thashë:

— Ku do të më shikosh mua tanë, ti e braktise shkollën.

— Lëre, mos ma kujto gabimin që kam bërë. Megjithatë po e ndreq. Kam hyrë në shkollën e natës.

— Mirë ke bërë se kështu fiton edhe para edhe shkollën.

Genci qeshi, qeshi edhe Mirjana. Bëmë një copë rrugë të tre, pastaj Genci pa orën e tha:

— Mua do të më falni, — e u nda.

Ecëm edhe një copë rrugë në heshtje, Genci ma kishte prishur humorin, kur Mirjana më thotë:

— Nuk është djalë i keq ky Genci, unë kam besim se do ta mbarojë shkollën me sukses.

— Mua nuk më intereson se ç'do të bëjë ai, edhe ti s'ke përsë të bëhesh merak!..

Përgjigjja ime pak e ashpër e hutoi Mirjanën. Uli kokën kurse unë shtova:

— Isha nga shtëpia, nëna nuk e dinte se ku kishe vajtur, po të mos kisha kaluar këtej, mbështetur do të takoheshim.

— Isha në bibliotekë, atje takova Gencin.

— Mjaft me këtë Gencin, — fola nëpër dhëmbë po ashpër.

— C'pate, Ilir?

Ajo e kishte nuhatur shqetësimin tim, por në vend që të qeshte siç bënte sa herë i hidhja ndonjë romuz, rrudhi vetullat e shtangu.

— Nuk dua të shoqërohesh më me atë njéri, — thashë prerë.

— Po flet përcart më duket... Ç'do të thuash, c'të bren?

— Në qoftë se këtu ka pér të folur, eja e folë ti.

— Po çfarë duhet të të them' unë, kur s'kam asgjë pér të të thënë.

Mirjana i theksoi fjalët e fundit e në atë zë ndjeva keqardhje e pezmatim. Nuk e kuptoja se e kisha fyer, por, duke menduar gjithnjë me mendje të nxeh të e duke dyshuar se mos ajo më fshihte diçka ndjehesha pér vete i fyter. Gjersa mbërritëm në shtëpi nuk këmbyem asnjë fjalë. Te porta e shtëpisë ajo më tha:

— Më kot zemërohesh. Unë e kam shok si edhe ti Gencin. Prandaj intimitetet që ti imagjinon hiqi nga mendja njëherë e mirë.

Zëri i saj qe i butë e i kthjellët, në atë zë nuk kishte asnjë ton pasigurie apo frike, por megjithatë sepse më dukej i shtirë. M'u duk sikur diçka m'u thyen përbrenda dhe ashtu fillova ta lodh mendjen me pandehma. Në leksione rrnim në bangë të ndryshme, ndërsa në pushime ikja, dhe ikja ime ishte aq e çuditshme dhe e pashpjegueshme sa që nuk kishte si të mos e dëshpëronte Mirjanën. Edhe pér pushimet e verës ika vjedhurazi. Ajo kishte dalë në stacion të më përcillte, po kë të përcillte, unë kisha ikur me trenin e parë, ia kisha mbathur si hajdut.

Në vagon ishin ca studentë që këndonin e tallëshin me njëri-tjetrin. Kënga përhapej në të gjithë vagonin sa e këndshme aq edhe gazmore, ajo shkrijët me trokëllimën monotone të rrotave, përhapej

gjatë shinave dhe tretej në erë. Nga dritarja sodisja kodrat, arat e pemët që më fluturonin përpara syve, ndërsa kënga kishte marrë hov e tani këndonin të gjithë ç'ishin në vagon, veç unë e kisha mbytur gëzimin... U pajtova me Mirjanën në shtator. I kërkova të falur për sjelljen pa mend dhe ajo e quajti të shkuar e të harruar. Për Gencin nuk folëm asnijëherë, ndërsa tani, më doli përsëri përpara. Ai kishte vendosur të jetonte në fshat si dhe Mirjana! U lëshova sikur m'u këputën pejzat.

Nuk e di sa zgjati kjo gjendje. Po q'desh ajo që zinte në gojë emrin e atij njeriu? Përsëri mendimi torturues se mos ajo me të vërtetë më fshihte diçka, m'u bë tundues. Mos vallë duhej të mos mendoja më për Mirjanën që të shpëtoja nga ajo torturë? Mos desha t'ia mbush mendjen vetes se ajo dashuri s'pat qenë veçse një ëndërr dhe se Mirjana as që ekziston te, por qe thjesht një trillim i fantazisë sime. Inati për atë vendim të pamendar të Mirjanës po i linte vendin urrejtjes për Gencin që po ma mbushte zemrën. «Mirjana më priste të veja sa më parë!» Por e keqja më e madhe ishte se unë mendoja në vetmi e kjo qe një torturë e pamëshirshme, mendimet e mbrapshta më qenë ngulur në tru e më hanin si ndryshku hekurin. Ajo priste e unë heshtja.

Por kishte raste kur i thosha vetes: «Pse hesht?» Tamam kjo pyetje më tërbonte. Mos vallë kjo topitja ime qe një tekë e karakterit? Mos unë s'isha gati të viajatje ku më thërriste atdheu, ashtu siç bëri Mirjana? Mos unë isha një egoist? Mos dashuria ime për Mirjanën qe një hipokrizi?...

Sikur t'ia kisha hapur zemrën atij burri, ndoshta...

— *Nuk je mirë djalë, sec ke, sec të mundon. Të*

pashë që në zyrë e të rashë prapa. Hajt, folë s'të lë-më ne të hash veten kështu!

Më kishte zënë ngushtë. Ai më vështron te në be-be të syrit me një buzëqeshje të ëmbël e me një përkujdesje prej babai. Tiparet e fytyrës së tij aq të ashpra, si të ngurta, befas ishin bërë të buta, flokët e thinjura e të prera shkurt, që gjithnjë ia pudroste pahu i kantierit, për çudi i ndritnin, dy rrudha që ia prisnin faqet deri pranë mjekrës, sikur iu zgjatën edhe më, ndërsa zëri i tij ishte i ëmbël po i prerë. Ul pranë meje, nxori kutinë e duhanit e shtoi:

— S'ka hall që të mos i bëjë ballë njeriu, de!

Dalngadalë ai njeri i mirë, po ma pushtonte zemrën. Nisa të flas. Ai më dëgjonte me mierak e tundte kokën; herë pohonte, herë mohonte, por kishte raste kur ulte sytë përdhë dhe hiqte cigaren me duf. sytë përdhë dhe hiqte cigaren me duf.

— Dëgjo, djale, ta themi ashtu siç është e vërteta, — brofi më në fund. — Ajo ta paska bërë bromb, e më i lumtë! Qenka më përpara se ti. Sa për punën e atij Gencit, hiqe nga mendja.

Karpentieri heshti një copë herë, drodhi edhe një cigare nga kutia prej alumini, në kapakun e së cilës qe gdhendur një shkabë e një yll, dhe shkriftoi zérin:

— Të ka zënë ca rehati ty, duket sheshit, po se mos vetëm ty, edhe ata shokët e tu e shikojnë si me frikë këtë punën e fshatit. Hajt, tunduni nga vendi, se s'ka kush t'i ndërtojë shtëpitë e rrugët në fshat.

Ai shtriu dorën përpara dhe e vuri mbi timen. Pëllëmba e tij lëkurëplasur e tërë kallo, ishte më tepër e ngrohtë se sa e ashpër. E shtrëngoi fort dorën time, e mbajti një copë herë në të tijën e foli përsëri:

— Atje, djale, ka punë edhe për inxhinierët.

Fjalët e tij ishin të çiltra e të shkoqura. Më dukej sikur me duart e tij të forta, po shkulte një mish të huaj nga trupi im, më dukej sikur nuk gjeja dot asnjë fjalë për të shprehur sadopak atë që ndieja, ndofta edhe lëkundjen time apo shqetësimet, apo kundërshtimin tim. Pa vetëdije kisha nxjerrë çelësin e apartamentit dhe po e vërtisja nëpër duar. Më vinte për të qeshur. Ai çelës rëndonte shumë në dorën time. Ai ishte çelësi i èndrrave të mia. Deri para pak ditësh kisha menduar vetëm për të, por kur ma dorëzuan s'arrita të gëzohesha.

Psherëtiva padashur, ndërsa karpentieri më rrahu supin. Ngrita kokën e dallova në fytyrën e tij një dritë gëzimi.

— Shkruaji vajzës, — tha, — është më keq kur e lë pa përgjigje.

U ndava nga karpentieri me zemër të ngrohtë, i shtrëngova dorën fort dhe e falenderova, ndërsa shikimi i tij në çastin e ndarjes m'u duk i rrëmbushur.

Kur mbeta vetëm, kishte rënë muzgu. Qielli qe qëruar më në fund e ndriste si xham, ca yje qenë ndezur, një plep i lartë fëshférinte, petalet dridheshin por as që e ndieja flladitjen e mbrëmjes. Digjesha flakë, kisha etje, më dukej sikur po më avullonte trupi e po më thahej mishi. Mora rrugët dhe ja kallova sheshin «Skënderbej»...

Duke parë ujin që cërriste nga shatrivani, më vinte të futja buzët në atë ujë me lëmashk.

Dhe në ato çaste ndieja lodhje të madhe shpirtërore, pas asaj lëngate të gjatë që ia kisha shpikur vetes. Mirjana më priste, ndërsa unë...

U ngrita me rrëmbim sikur të isha zgjuar nga ndonjë èndërr e frikshme dhe futa kokën në hauzin e shatrivanit. Rreth meje kishte pllakosur heshtja, një

dritë e zbetë të shponte si me ca shtiza të vërdhemta gjethet e një bliri dhe binte mbi hauz, si një copëz mjegull e bardhë. Piva ujë me etje, thitha ajrin e ëmbël, plot aromë dhe ndjeva trupin të më shkrihej nga një ëmbëlsi.

belsi.

高
中
考

Autobusi frenoi befas. Disa metra më tej kishin shkarë ca gurë. Shoferi hapi portën e kërceu jashtë. Ashitë bëra edhe unë e disa pasagjerë.

— E shikon se ç'bëhet nga këto shkarrëzima! — tundi kokën me inat shoferi.

Ngrita kokën lart. Shpati thikë e i kuqërremtë, rrinte mbi ne kërcënues e sikur na përqeshte. Diku, në një rrip, një dëllinjë e vetme dridhej nga era që frynte sipër. Shkopsita këmishën e nxora gjoksin ja-shtë. Kisha djersitur dhe era që zbriste nga shpati, më hynte ëmbël në trup, më nanuriste e m'i largonte të gjitha shqetësimet.

MEKANIKU I TURNIT

Zeni ngjiti shkallinën e ngushtë me rrëmbim dhe ngriti llambën e gazit te kolona e nivelit të ujit.

«Ka akoma edhe gjashtë metro kub. Pra edhe tre orë punë!»

— Duhet ta kufizojmë konsumin e avullit, — thirri që nga maja e shkallinës së rezervuarit.

Kaldaisti që e vështronte me habi e pak si me dyshim që poshtë, përpara furrës së zjarrit, flaku ganxhën dhe pështyu me potere mbi hirin e nxeh të që sapo kishte nxjerrë nga furra. Zeni zbriti poshtë, la llambën mbi një arkë dhe ferkoi témthat me pëllëmbë. Një psherëtimë e lehtë iu shkëput nga krahërori e ia hodhi shikimin kaldaistit që ende s'po e kuptonte shqetësimin e mekanikut të turnit.

— Do të japësh avull vetëm pér kazanët e zierjes, asgjékund tjetër. Unë do të mbyll të gjithë ventilat, nuk kemi rrugë tjetër, — foli Zeni gjithnjë duke ferkuar témthat.

Kaldaisti hapi portën e furrës dhe hodhi një synë zjarrin e vatrës, mori ganxhën, trazoi qymyrin dhe e mbylli me forcë portën. Zeni kishte rënë në mendime.

Tufani qe tèrbuar atë natë. Herën e tretë kur u ndërpren korenti, Zeni kishte vajtur vetë në kabinën e transformatorit dhe atje mori vesh nga elektricisti, se e gjithë zona s'kishte korent.

Në fabrikë kishte pasur telash, qe bërë rrëmujë e errësirë, elektromotorët kishin pushuar punën përnjëherësh. Një errësirë kërcënuese e kishte mbësh-tjellë fabrikën dhe punëtorët me fenerë nëpër duar, vraponin te motorët e te makinat. Pak më vonë lajmëruan se diku në fushë kishte rënë një shtyllë e tensionit të lartë. Ky lajm e kishte ngurosur Zenin. Kishte dalë nga kabina i pikëlluar dhe tërë mendimet ia kishin pushtuar kazanët e zierjes që ishin në gjysmë proces.

«Po tan? Lojë me zarar të madh kjo! Hë pra, tan? qdo të bëjmë, na duhet avull, na duhet ujë, na duhet korent!»

Me këtë andrallë kishte hyrë në korpusin kryesor të fabrikës. Punëtorët, me fenerë nëpër duar, i pa tek vraponin të ulnin çelësat, të mbyllnin ventilat, saraçineskat. Diku dëgjoheshin shkarkimet e ujërave që ktheheshin mbrapsht ngaqë pompat s'punonin.

Errësirë. Asnjë lëvizje, asnjë zhurmë makine. Si-kur të qe shuar jeta në fabrikë, qdo gjë heshti.

Dëgjohej vetëm ulurima ngjethëse e tufanit që përplasej pas mureve, pas xameve. Hapet një dritare, dhe thyhen disa xhamë. Dikush shan e mbyll dritaren.

Vetëm në repartin e kaldajave ka jetë, atje aparatet purojnë, prodhohet avull. Kërcëllima e lehtë e qomyrit që digjet në furrë, ajo farë shushurime që bën avull në kazan e në tuba, si edhe ngrrohtësia që shpërndan kaldaja, plotësojnë atë që quhet jetë. Këtu ka vërtet jetë, ka punë, ka dhe ngrrohtësi. Hirat e shllaku i qomyrit ndriçojnë e japid edhe ato nxehësi, përzier me erën e squfurit që të ngacmon hundët dhe fytin.

— Si jemi me ujin e kazanëve? — pyeti Zeni kaldaistin.

— Kazanët kanë mbi nivelin minimal.

— Po rezervuari?

— Po mbaron!

Zeni fërkoi përsëri tëmthat.

«Çfarë do të bëjmë, do ta përballojmë këtë avari, do t'i mbajmë dot kazanët me avull?»

Këto pyetje e brejnë, nuk mendon gjë tjetër veç produktit që është në gjysmë proces.

— Nuk kemi rrugëdalje, Skëndo, duhet të kufizojmë avullin vetëm pér kazanët e zierjes, — tha Zeni me zë të ulët sikur të fliste me vete.

— E di, more Zeni, atje më punon mendja edhe mua, ama kaldaja do ujë.

— Ç'të bëjmë tjetër?

Kaldaisti mblodhi buzët më mosbesim, i hodhi një shikim ndihmësit, niveleve të ujit e u kthyesh nga Zeni:

— Kam frikë se do të boshatiset rezervuari përrapa se të vijë korenti.

— Mos mendo ters, Skëndo, se atëherë duhet të heqim dorë nga përpjekjet, të mbajmë një procesverbal dhe t'ia këputim me gjumë.

— Të paktën të na jepnin korent sa pér të punuar pompat e ujit.

Zeni thartoi fytyrën dhe ai lëmsh që pak më parë i rëndonte kokën, tanë i kishte zbritur në krahëror dhe ia shtrëngonte zemrën. U mbush me frymë e foli përsëri me zë shushuritës:

— Pér tre orë do të rregullohet, unë kam besim, punëtorët kanë dalë në fushë e po punojnë në mes të tufanit, që ta ndreqin linjën, kurse ne po rrimë duar-

kryq, s'pon bëjmë asgjë... Edhe ne duhet të bëjmë
diçkam duhet të gjemë ujë edhe sikur...

Fjala i mbeti përgjysmë. Skëndoja e pa përsëri
me dyshim dhe ngriti supet.

— S'na e kanë dëgjuar zérin; sa herë kemi thënë
për ata të shkretë rezervuarë! — tha i zemëruar Skën-
doja.

Vërtet, sá e sá herël ishte biseduar për të shtuar
kapacitetin e rezervuarëve të ujit në fabrikë. Ishin
bërë edhe skicat e instalimit, qenë projektuar edhe
rezevuarët... Tërkuzë qe bërë ajo punë. Të gjithë e
kishin gjetur të drejtë dhe e kishin përkrahur propo-
zimin e Zenit, por kur kishte ardhur puna për ta zba-
tuar kishte ngecur në vend sepse në lokalin e rezer-
vuarëve të ujit s'kishte pasur vend h të lirë për të
shtuar të tjerë.

— Edhe unë kam faj, — tha Zeni, — nuk kam ngu-
lur këmbë, se edhe vendi do të gjendej.

— Unë s'do ta lë me kaq këtë punë, o Zeni. Edhe
sikur të mos kishte ndodhur kjo avari, unë kisha ve-
ndosur të kërkoja që propozimi yt, për shtimin e re-
zervuarëve, të vihej në jetë, ama tani që ndodhi kë-
shtu...

— Tani edhe ata do të binden se kjo çështje nuk
pret më, — plotësoi Zeni.

Shpeshherë takon që avaritë të vinë që të gjitha
së bashku, sikur duan të të shtypin fare. Kështu ndo-
dhi edhe atë natë dimri. Në një anë mungesa e ko-
rentit dhe e ujit, në anën tjetër tufani me borë e acar.

* * *

Punëtorët punojnë. Zeni ua ka ndarë detyrat
secilit dhe vetë punon atje ku është më vështirë. Të
gjithë punojnë me nxitim. Shkarkojnë ujin nga tubat

boshatisin pompat, hapin fllanxhat e rakordet, zbrazin ujin e «vdekur». Rreziku i ngrirjes u qëndron të gjithëve mbi kokë si një përbindësh. Xha Thimi, një punëtor i vjetër, pështyn mbi truall e u tregon shokëve se si ngrin pështyma sapo bie në tokë.

— O burra djema, të zbrazim ujin se do të na e bëjë gjëmën ky acar, s'të ka besë ky, të ngrin goll-gan!.. — nxiste punëtorët xha Thimi duke ngrohur duart me frymë.

Celësi i ftohtë akull të ngjitet në dorë e ta djeg lëkurën sikur t'i kishe lagur pëllëmbët me eter. Zeni vë pëllëmbët nën sqetullat; ndërsa xha Thimi, që i janë mpirë, pushton qelqin e fenerit, por sa gënjejnë veten. Duart s'i ndiejnë. Por ujërat duhen zbrazur, ky është një urdhër në vetëdijen e secilit, është i vetti mi qëllim i atyre çasteve. Duhet evituar ngrirja e ujut në tuba, duhen shpëtuar pompat.

Fenerët e gazit lëvizin pa pushim si ca sy të zjarrtë, drita e mekur, që shpërndajnë qelqet e nxirë të fenerëve i ngjan një perdeje të çjerrë që luhatet cep më cep. Ashtu, si nëpër mjegull, të përgjysmuar e të ngrënë duken edhe njerëzit, makinat e gjithçka. Gjithçka, ka një pamje ogurzezë, kërcënuese, por askush nuk hiqet nga rruga e vet, askush nuk ankohet.

— Hëni, djema, se ka ardhur puna që të maten minuta. Sa të numërosh dhjetë, t'u bë uji akull; është i pabesë ky acar! Hëni, të shpëtojmë pompat, se po e ndërprenë punën, do të na çahen e do të na mbeten në dorë! — u jep zemër punëtorëve xha Thimi.

Tingujt metalikë të çelësave dhe zhaurima e ujrale që shkarkohen i ngjan një muzike të paakorduar, çoroditëse. Zeni kontrollon një për një tubat, pompat, saraçineskat. Shqetësimi e ka pushtuar si me kthethra. I duket se edhe zemra po i luan nga vendi.

Xha Thimi e shikon vetullngrysur e tund kokën. S'është ai Zeni i mëparshëm, shakatar e i gjuar.

«Ndryshon puna sot. Këtu s'kanë vend fjalët, jo! Punët sot janë si në luftë!...» — mendon xha Thimi.

Fabrika hesht, dhe në atë heshtje që i ngjan një brejtjeje të pamëshirshme Zeni ndien përgjegjësinë e thellë të punës. Një tub është si një dorë e tij. Një pompë është si një mushkëri e tij dhe uji që po shter është si gjaku i tij. Diçka i ther në krahëror. Është një mendim i shëmtuar. Mbyll sytë dhe rreket ta hedhë mendjen gjetkë, por më kot. Ai nuk mund të mbylli sytë përpara kësaj gjëme që ndodhet fare pranë. Produkti në gjysmë proces i ngjan një të së-muri që po përpilitet e që mund të vdesë atë çast. Zeni shkund kokën, trupin, e mbushet me frymë. Vrapon te kazanët e zierjes e shtang. Produkti zien, hedh vale. Dhe ai kërkon që kjo vale të rezistojë.

Përsëri ai përfytyrimi rrëqethës e pushtoi. «Ja, vala do të bjerë dalngadalë, do të shuhet, do të fashitet... Pastaj? E çë pastaj! Do të hapim saraçineskat e do ta derdhim në kanal produktin, kanali do të gurgullojë, do të shkumbëzohet... Jo, jo, kjo është e tmerrshme, është fundi!»

I duket se largimi i kësaj së keqeje është në dorën e tij, i duket se dhjetra sy janë kthyer nga ai dhe presin se çdo të bëhet, kurse ai s'po bën asgjë.

Një mendim i marrë i ka shkrepur në kokë. «Nata do të mbarojë dhe kur të ndërrrohet turni do të merret vesh se kazanët mbeten pa avull dhe produkti u prish!»

Cdo t'u thotë ai shokëve. Përsëri një si thikë i ther në krahëror. Pa orën. Tufani ulurin e korenti ende s'po vjen, ndërsa nata zbardh nga dëbora dhe termometri është ulur në minus tetëmbëdhjetë. Ze-

nit i shpëtoi një pshëretimë. Shkarkimi i ujërave ka mbaruar, detyra e parë u plotësua, tani mbetet detyra tjetër, më e vështira, më e rëndësishmja. Duhet shpëtuar produkti.

— Punëtorët e qullur dridhen nga të ftohtit. Xha Thimi kërkon të pijë një cigare po s'i bëjnë duart, të ndezë shkrepsen.

— Ç'na qe kjo e sotmja, xhanëm! ?... Ptu, s'e zë dot e vajti! Kush do të ma ndezë, o djem, se s'e zë dot kleçkën me gishta!

Dikush shkrepri një çakmak e xha Thimi e thithi thellë tymin,

Një copë herë të dukej se tërë mendimet dhe dëshirat e tij qenë mbledhur rrëth asaj cigareje. Ai e thithte dhe i vështronte me ëndje tymin e zjarrin. Nuk i ngrinte sytë fare, ishte mbledhur në yetvete, nuk mendonte asgjë përveç duhanit. Por ndofta ishte lodhur dhe ashtu mblidhte veten e fuqitë, ndofta kishte ngrirë e s'e ndiente trupin të tijnë apo po ngrinte pjesë-pjesë...

— Shkonit të thani rrobat, shokë, — u tha Zeni punëtorëve, dhe iu afroa xha Thimit.

Plaku ngriti sytë, lëvizi buzët, qeshi:

— Edhe ti, more bir, më keq se ata ke ngrirë! Apo s'e shikon se si të janë bërë kominoshet, na mu si kerc nga akulli! — e i preku rrobat.

Zeni pa rrobat e mblodhi supet sikur të donte të thoshte: «Unë s'jam lagur fare!», ndërsa xha Thimi i hodhi dorën në sup dhe i pëshpëriti:

— Keq i kemi punët, o djale, ama mos ta lëmë të vejë më keq. Duhet bërë derman se do të na mbulojë turpi, duhet ta kthejmë përmbyss e ta shpëtojmë produktin, po ec të vemë në kaldajë, te Skëndoja, duhet të thahemi njëherë.

Në rezervuarë kishte mbetur fare pak ujë. Niveli tregonte gjysmë metri kub, aq sa të mund të bëjë pesëmbëdhjetë minuta avull. Zeni kafshoi buzën. Nga kominoshet e shkrira i pikon ujë, avulli i teshave po ia ngroh trupin dalngadalë, por ai ose nuk e ndien atë ngrohtësi ose nuk e kuption nga i vjen. Truri i tij kërkon të sigurojë ujë. Shushurima e avullit në kazan dëgjohet si edhe më parë, edhe zjarri në furrë digjet me furi, e përpin tufani e acari, e bashkë me zjarrin po zhduket edhe uji, avulli, që brendështetet tubat e kazanët e u jep jetë. Avulli në fabrikë është si gjaku në trupin e njeriut!

Edhe pesëmbëdhjetë minuta... Pastaj do të nxirret zjarri nga furqa e kaldaja do të ftohet vete-tiu, si trupi i një të vdekuri.

Xha Thimi merr një thëngjill dhe ndez cigaren. Zeni shikon kaldaistin. Secili tret mendime apo pret një fjalë nga shoku. Drita e fenerëve ndriçon fytyrat e punëtorëve me një dritë të zbetë. Në ato fytyra spikat lodhja e pezmatimi, por duket edhe shpirti i ndezur e ndjenja e përgjegjësisë.

— Vala po bie, — u dëgjua një zë që erdhi nga porta. Ishte një nga punëtorët e repartit të kazanëve të zierjes.

Punëtori qe tepër i shqetësuar, sytë i lëviznin pa pushim, edhe fikthi i lëvizte poshtë e lart në grykë.

— Nga do t'ia mbajmë tani?! — shtoi punëtori me zë të mekur.

— Do të turpërohem tanë në pleqëri, — tha me zemërim kaldaisti dhe flaku tutje ganxhën e zjarrit.

— Dale de, mos e lësho zemrën ti, Skëndo! —

mërmëriti xha Thimi që mundohej të fshihte shqetësimin.

— S'kam ujë, s'kam ç'të bëj! — thirri e pështyu mbi hi Skëndoja.

— S'do ta lemë! — ia priti Zeni dhe zëri i tij kumboi si një zë në shkretëtirë.

— ?!

— Do të gjejmë ujë, — shtoi Zeni me një shkëlqim në sytë e tij, — do ta ushqejmë kaldajën sa të na japë një curril avulli, aq sa ta mbajmë valën të gjallë.

— Ku do ta gjesh këtë ujë, o Zen, — pyeti Skëndoja i habitur dhe i nervozuar.

— Ore Skëndo, mos ti paske dert më shumë se ne, o? Prit ore, njëherë, të shikojmë ç'mendje ka djali, — iu hakërrua xha Thimi.

— Kam një orë që po e vrash mendjen. Ndofta është marrëzi ta thuash e aq më keq ta bësh, por unë s'po gjej rrugëdalje tjetër. Përgjegjësinë e marr vetë... S'besoj të shkaktoj ndonjë dëm, po përpinqem vetëm pér të mirë, të shpëtojmë produktin, të mos hedhim në kanal tridhjetë mijë lekë...

Të gjithë po e vështronin Zenin me habi. Ku do të dalë ky? ç'ka ndër mend të bëjë vallë?

Niveli i ujit në kaldajë po ulet. Caste kritike! «Duhej vepruar shpejt, duhej hequr zjarri nga furra, duheshin mbyllur ventilat e avullit...

Mendimet e rrihnin pa pushim Zenin.

— Mos hidh qymyr më, — tha Skëndoja ndihmësit. Dhe kjo fjalë u theri zemrën të gjithëve e u tha punëtorëve: «Mjaft edhe ju!»

— Edhe pesë minuta, — kërceu Zeni. — Edhe pesë minuta, unë do të shkoj, vendosa, do ta përdorim ujin e kazanëve të ftohjes! Çdo kazan mban një

metro e gjysmë kub ujë, kështu do të kemi avull edhe për një orë e gjysmë. Kaq mjafton që të përfundojë zierja! Uji është i pastër!...

Xha Thimi i hodhi dorën në sup dheëmbëlsinë e syve e derdhi mbi Zenin. Skëndoja po çakëriste shtë, të tjerët mbetën gojëhapur si të goditur nga diçka e rendë që të shastis e të merr mendjen.

— Është punë me përgjegjësi kjo, — tha me shtë përdhe Skëndoja.

— Do të përgjigjem unë pér gjithçka!

— Edhe ne do të përgjigjemi, të gjithë së bashku! — shtrëngoi grushtin xha Thimi.

— Unë nuk besoj të dëmtohet gjë. Do të çrrëgullohet ca regjimi i temperaturave, po, nuk prish punë. Kjo nuk sjell pasoja të dëmshme. E keqja më e madhe është te kazanët e zjerjes dhe unë po zgjedh të keqen më të vogël. Ku'r të vijë korenti, kazanët e ftohjes do t'i mbushim menjëherë me ujë.

Xha Thimi i rrahu përsëri supin Zenit e tha:

— Na thuaj, o djale, çfarë duhet të bëjmë ne?

— Ja, do të bëjmë atë që thamë, — foli Zeni dhe vrapi jashtë.

* * *

Pas atyre fjalëve që tha Zeni, në repartin e kal-dajave, u bë përsëri heshtje. Kaldaisti bënte ec e jakë me merak të madh dhe mendja s'i hiqej nga Zeni e nga kazanët e ftohjes. Një çast u ndal, atëherë tufani u përplas fuqishëm mbi dritaret e theu xhamat e tjetërë, por Skëndoja nuk ia vuri veshin atij rrebeshi. Mori lopatën, hapi portën e furrës dhe hodhi qymyr.

Nga dritaret e veshura me borë e akull, dukej drita e vagët e llambës së gazit dhe hijet e njerëzve.

Xha Thimi i bënte dritë me fener Zenit dhe ndiqte me sy lëvizjet e shkathta të duarve që mbyllnin një palë saraçineska, dhe hapnin një palë të tjera, ato që s'ishin hapur kurrë.

Kur zbritën në repartin e kazanëve, të gjithë kullonin ujë, duart u qenë mavijosur, nuk ndienin asgjë! Ata jetonin tanë çastin më të lumtur dhe vështronin me gëzim valën që sa vinte rritej e ludronte përpara syve të tyre. Zenin s'e mbante vendi.

NGJARJE NË KANTIER

Mëngjeset me diell janë të bukura në kantieret e ndërtimit. Drita e verdhë e diellit, diku me shufra të arta, bie mbi tullat e i përflak, bie mbi rërën e u jep ndriçime grimcave të kuarcit, bie mbi xhamet dhe i vetëtin, bie mbi skelarinë dhe e ndrit kudo. Hijet e stërgjatura të skelarisë shtrihen mbi sheshin e punës si ca shulica të ndërthurura. Drita e ëmbël ngroh e trazon të gjitha sendet e kantierit, kantierin e njerëzit vetë dhe në orët e para të mëngjesit ndien më shumë se kurdoherë afshin e dheut, erën e llaçit, të ziftit e të dérrasave.

Atë mëngjes, kantieri ende s'qe zgjuar, kur befas gulçoi një motor e nga gryka e skapamento së tij, u rrrokullisën bufkat e tymit, u përhapën si një re ngjyrë plumbi dhe krijuan një hije që lëvizi me përtim mbi dheun e shkriftë. Motori rënkoj edhe më fort, buldozeri u shkund, zinxhirët kafshuan dhe ruspa filloj të gryejë e të shtyjë kube dheu.

Uturima e motorit herë ngríhej lart si piskamë, herë binte, ulej gati sa nuk shuhej sikur makina të zhytej në ndonjë pellg me llucë. Ylli iu mëshoi leva ve e makina e bindur kérceu e u drodh si të ishte një genie e gjallë. Kamionët vetshkarkues dremtinin atje ku i kishin lënë shoferët një ditë më parë. Mbi

kamionin e Bashkimit, binte një rreze dielli dhe nga xhamet e fenerëve reflektorej një dritë që të verbonte sytë.

Ylli atë mëngjes e kishte filluar punën që herët, dhe, kur u hap porta e madhe e kantierit e sajuar me dërrasa e me trarë nga ato të skelarisë e punëtorët filluan të hyjnë grupe-grupe, ai kishte bërë shtatë gërryerje.

—Mirëmëngjes, Ylli! E paske zënë punën me vesë sot?

— Sapo fillova.

— Do të bësh dy norma sot, apo jo? Mirë, po jepi djalë, jepi se zor e kini, u ka vënë puna përpara!

Yllit iu dukën fjalë të rënda këto, kafshoi buzën dhe në çast u zemërua me karpentierin, por më pas e pa se më kot zemërohej dhe padashur përsëriti edhe vetë fjalët e tij.

«Zor e kini, u ka vënë puna përpara!» Qeshi dhe tundi kokën. «Ai burrë ka të drejtë, ai tha të vërtetë!»

Këtë e dinin mirë Ylli, Bashkimi e Cenoja. Bile, për këtë të vërtetë ata ishin ngrënë sa që Bashkimi qe zemëruar me Yllin dhe kishte rrezik të prishej treshja e tyre.

Ylli dalloi Bashkimin. Ai bariste me hapa të ngathhta, sikur hiqte këmbët zvarë, tundte xhaketën që e mbante në dorë dhe fërshëllente nëpër dhëmbë. Ylli zbrazi mushkëritë shuajti motorin, kérceu nga kabina jashtë, mori një tufë penjsh dhe misi të fshinte duart. Me sy ndiqte Bashkimin, që po afrohej. Bashkimi, shoferi i kamionit vetshkarkues, hipi mbi parafango e po hapte kofanon.

— Mirëmëngjes, Bashkim! Përsëri me kandelet?

— E or e... Nuk më jep kjo e treta, seç ka që më laget...

Ylli uli sytë përdhé.

— Si të zë gjumi kur e di që motorin s'e ke në rregull?!

Bashkimi ktheu kokën me përtim, gjithnjë duke fërshëlyer nëpër dhëmbë, dhe e pa vëngër. Pa e përfillur u përkul sërisht mbi motor. Pak më tutje, Cenoja, shoferi tjetër, ngriti dorën në shenjë përshtëndetjeje dhe shkeli pedalin e gazit që të dëgjonte zhurmën e motorit.

Ylli ishte në mes tyre, por në një çast sepse e pa veten të vetmuar, të fyter e të pafuqishëm. Ai karpentieri kishte thënë një të vërtetë dhe fjalët e tij i rrithnin si çekan mbi kokë. Pa fytyrën bullafiqe të Bashkimit. Ai qe trashur kohët e fundit. Ndërsa zëri për çudi i kishte mbetur i hollë e i pasigurtë, si zëri i një djalurçine.

— Edhe sot s'i ka punët në rregull ky, — i tha Cenos që sapo kishte dalë nga kabina, — siç duket puna, do të pengohemi përsëri.

— Më plasi, — rënkoj Bashkimi sikur të fliste me vete dhe e pështyu kandelen.

— S'do të kesh kontakt, — ndërhyri Cenoja, — pa dale t'i hedh një sy.

— Do t'i frysh ti, a? — mërmëriti Bashkimi.

— Do t'i fry, — tha Cenoja dhe hipi mbi motor, ndërsa Bashkimi duke fshirë duart me një shuk penjsh trikotazhi, nuk e ndërpriste fërshëllimën.

— Shiko këtu, s'ta ka fajin kandelja, po bobina... Vërja veshin punës, hapi sytë, se na e hëngre shpirtin! — iu hakërrua Cenoja, e duke ndezur motorin i dha gaz e shtoi:

— Dëgjon... e ke në rregull tanë, ama shiko se

tjetër herë s'të vë dorë në makinën tënde, se edhe vetë nuk i le të tjerët të trazojnë makinën time!

Ylli ndjeu një hidhërim të madh në gojë. Ndofta nga duhani që e kishte ndezur që me natë, ose nga ai djall. Bashkim... Përsëri ato fjalët e karpentierit ia çukitën kokën.

— A e dini se na ka vënë puna përpëra, — tha rrëmbimthi. — Dje bëmë fjalë, sot përsëri po e fillojmë punën me vonesë dhe s'dihet... Ama, duhet ta dini se brigadën tonë po e mbajnë nëpër gojë. I gjithë kantieri flet për punën 'tonë të dobët... A s'është turp? ! As normën s'po bëjmë, le pastaj! ..

— Vërtet që na ka vënë puna përpëra, — Cenoja i tha këto fjalë si një pshëretimë dhe flaku cigaren me inat.

— Duhej të kishte filluar hedhja e plintave, ndërsa ne s'kemi bërë akoma zbarkimin e dheut. Jemi një javë prapa. E kuption ti, Bashkim, çdo të thotë, një javë prapa?

— E pastaj, punë e madhe.

— Si punë e madhe, more tutkun! — brofi Cenoja dhe u mbush me frymë.

— Ti, Bashkim, duhet ta mbledhësh mendjen, e t'i matësh fjalët! — tundi gishtin Ylli.

— Ti po na turpëron, prandaj duhet të hysh në binarë. Përditë difekte, përditë pengesa, moskokëcarje... Çdo të thotë kjo? !

— Ou se mos e kam unë në dorë, kësaj karaktevine s'kam c'ti bëj unë.

— Ti ke borxh ta mirëmbash e t'i qëndrosh mbi kokë; po puna jote duket, nuk e çan kokën! Nuk të paguajnë vetëm për timonin, këtë ti e di mirë, — ckërmitti dhëmbët Cenoja.

— Oj! Pse mos më paguajnë edhe si mekanik?...

Unë shofer jam, timonin kam! Ja ku eshtë makina, le të vijnë mekanikët, për atë punë paguhën. Ja ku e kanë le t'i pijnë lëngun. Jo de, e tillë eshtë makina, të tillë punë do të japë!

— Këto profka s'të pijnë ujë dhe mos na i shit ne këtu, ne marrim vesh nga motori, prandaj fajin e ke vetë. Ti ia ke varur makinës! Apo jo? Nuk punon njeri si ti!

— Ti, Ylli, mos më shit mend, shiko punën tënde, atje, — zgjati dorën, — buldozerin shiko ti, me kaminionin tim mos u përzie!

Yllit i rrahën tëmhat, u nxe, ca fjalë iu ngatërruan nëpër gojë, bëri një hap drejt Yllit, por Cenoja i doli përpara. Sytë i qenë ndezur, duart i dridheshin, kafshoi cigaren e hodhi poshtë e klithi:

— Nuk të le të flasësh kështu, unë! More vesh? Nëse nuk do të kuptosh se punimet u avancuan, në harrove zotimin e kolektivit për ta dorëzuar objektin dy muaj përpara afatit, nuk harrojmë ne dhe s'të lemë edhe ty që të harrosh! — Cenos iu mor goja.

— Ti duhet të na dëgjosh ne, se ne s'kemi pse të të shajmë kot. Interesi ynë eshtë objekti.. — ndërhyri Ylli.

— E more vesh se si eshtë puna, — tha Cenoja me zë pák më të shtruar.

— Jo de, s'kam marrë vesh! — mërmëriti Bashkimi e filloj të fërshëllejë atë avazin e tij që t'i pikonte nervat.

— Aq sa merr vesh gdhéri aq merr vesh edhe koka e tij, — tha nëpër dhëmbë Ylli e u largua i flaskëruar.

— Ore Ylli, — thirri Bashkimi, — ç'borxh të kam unë ty, bre?

— Mua s'më ke aṣnjë borxh, por borxh i ke kantierit, shoqërisë!

Bashkimi u nguros, mbylli sytë përgjysmë dhe një çehre e verdhë ia mbuloi ftyrën bullafiqe. Gulçoi. Befas i shtrëngoi dhëmbët e i mbylli sytë fare, sikur t'i kishin hedhur prush në ftyrë. Ktheu shpatullat e rrumbullakta siç bënte sa herë kthente timonin përpara një pengese të papritur dhe përplasi kofanon e motorit e cila kërciti me lemeri. Yllit iu drodh ftyra e gati sa s'u kthyte ta përfshinte përgryke, por Bashkimi u nis menjëherë.

«Ky s'është në rregull,» — mendoi Ylli. Sjellja e Bashkimit iu duk shumë qesharake, por jo vetëm qesharake. Sidoqoftë ai s'kishte të drejtë të përplaste kofanon, ai nuk mund t'ia nxirrte inatin kamionit, ai s'kishte të drejtë, jo, kurrë! Sjellja e Bashkimit e nervozoi edhe Cenon, atij i cëmbuan në zemër krismat e kamionit.

«Bashkimi s'është në rregull. Ylli ka pasur të drejtë ndërsa unë kam bërë sehir, s'a kam vënë veshin këtij njeriu të prapshtë, këtij shtataniku» — mërmëriste Cenoja me vete.

* * *

Sjellja e Bashkimit dhe mëria që ai mbante, ia mbushte zemrën me duf Yllit. Po, Ylli nuk e duronte dot mërinë. Ashtu siç kishte pamjen e butë e paqësore, ashtu qe edhe me zemër e me shpirt. Treshja Ylli, Bashkimi e Cenoja, qenë lidhur me një miqësi të bukur. Dikur në kantier flisnin mirë për brigadën e tyre, ndërsa tani...

Disa javë më parë, Bashkimi qe i sigurt se drejtoria kishte vendosur lëvizjen e tij dhe e priste si

ujët e paktë ditën që të niste punë jashtë kantierit. Ai kishte bërë luftë, s'kishte lënë gur pa lëvizur e njeri pa iu latur që t'ia plotësonin dëshirën. Por tërë planet ia prishi Ylli, që e dinte. mirë qëllimin e Bashkimit dhe i revoltuar nga kjo e shtroi çështjen në mbledhjen e kolektivit e kërkoi që drejtoria të mos ia ndërronte vendin e punës pa u dorëzuar kantieri.

Bashkimi i kishte rënë me grusht gjoksit:

— Ç'punë ka me mua Ylli? Ç'do ai që fut hundët këtu? Unë dua punë, dua rrugë të gjata, ton, — kilometra, unë nuk dua t'i bëj bisht punës.

— Bashkimi do që të fitojë para më shumë, nuk pyet fare për humbjen e brigadës dhe as që mendon se angazhimin e brigadës sonë, për të dorëzuar objektin para afatit, do ta marrë lumi. Pastaj, shoku Ali, si shef i transportit, i ka premtuar kamion të ri, duke shkelur kështu si ai edhe Bashkimi zotimin që morëm për të punuar me automjetet që kemi deri në fund të pesëvjeçarit. Jo shokë, kështu s'jemi në rregull. Këtë praktikë pune duhet ta dënojmë dhe drejtoria duhet t'i shikojë ca më thellë këto probleme, — foli me vendosmëri Ylli.

Shefi i transportit qe mbledhur sa një grusht mbi stolin ku rrinte dhe nuk guxonë të ngrinte kokën. Diskutimit i dha fund sekretari i Partisë.

— E kam shumë të qartë, — tha ai, — fajin e Bashkimit dhe të Aliut. Çdo njëri nga ne duhet të heqë dorë nga premtimet e pretendimet. Ne nuk kemi kohë të merremi me vogëlsira dhe ata që e kanë mendjen te kamionët e rinj, le t'ia venë njëherë gishatin kokës. Ne zotimin e marrë do ta mbajmë.

Bashkimi kafshonte buzën e qe kredhur në botën e tij të vogël. «Paska qenë zemërlig ky Ylli, pa shiko se si ma punoi!»

I dukej sikur i lëviste toka nën këmbë, gulçonte e sytë i qënë mbushur me damarë të vegjël e të kuq gjaku. «Paska qenë i poshtër ky Ylli»

Trupi i rrëqethet si t'i hidhnin ujë të ftohtë në shpinë, duart i dridheshin dhe kamioni i ri, që pak më parë i dukej se e kishte në dorë, po i ikte, po i rrokullisej me shungëllimë, po i thërrmohej nëpër duar.

Buldozeri i Yllit e mbushte kantierin me gulçe e me zhurmë. Motori ulurinte nga mëngjesi deri në mbrëmje dhe herë pas here e ulte poteren sikur në ato çaste mbushte mushkëritë me ajër, por ajo «frymëmarrje» që fare e shkurtër, e ai hidhej gjithnjë përpara duke shpërndarë uturimën, apo duke plotësuar heshtjen që ishte ndehur midis Yllit e Bashkimit.

Një kub dhei po vinte drejt kamionëve. Kubi që i madh sa kapërderdhej nga buza e sipërme e rus-pës. Dhei i shkrifët e pak i qullët shkiste përpara dhe përhapte erën e mykut e të kalbësirës.

— Hapi sytë, do marrë apo s'do marrë shembull nga Ylli, — foli si me vete Cenoja.

— Do ta shikoj mirë kur të thyejë motorin — iu përgjigj Bashkimi — dhe fytyra sikur iu bymye edhe më, ndërsa vështrimi i që errësuar mbi kubin e dheut.

— Motorin s'e thyen ai, por do të thyejë normën, ndërsa unë do të thyej kokën tënde se na i ke sjellë shpirtin në majë të hundës. Na, mere, s'të bën kjo, shko i vëré syrin diellit tanë. Po si s'e ngryse një ditë pa difekt, brë?! — ulëriti Cenoja duke i flakur përpara këmbëve manikotën e ujtit të radiatorit.

Për shkak të asaj manikotës së radiatorit rridhte uji curkë. Sa herë që kthehej për të ngarkuar kamionin, Bashkimi përkulej mbi motor dhe merrej me manikotën, po më kot. Ajo ishte çarë, duhej ndërruar me një të re.

— Ah, Bashkim, Bashkim — foli Cenoja, ofshau dhe iku i çartallosur.

Bashkimi kalonte gjithnjë përpëra stendës së emulacionit, por asnjëherë nuk rrinte të shikonte atje. Sepse nuk i bënte përshtypje stenda dhe sa herë që kalonte andej thoshte me vete: «Ia kanë ngenë këta!» E quante të tepërt stendën e emulacionit dhe ata njerëz që merreshin me të i kishte marrë për zët. Por atë ditë dikush e thirri:

— Hajde Bashkim, se të paska dalë emri!

Bashkimi zgjati kokën që prapa shpinës së punëtorit dhe u nguros.

— E meriton, — tha dikush.

— Me hak. Kamioni i Bashkimit edhe sot s'punon, — tha një tjetër.

— Më iu lumtë atyre! Shok e kanë vërtet por s'ia kursekan «kopaçen».

Bashkimi e kishte humbur pusullën. «Vërtet ata e paskan shkruar këtë fletërrufe?!»

Punëtorët të gjithë kishin kthyer sytë nga Bashkimi. Ai përpëliti kapakët e syve dhe ngriti kokën, por vështrimi i tij qe pa shprehje e pa dritë, ai vështrim kishte një perde të mjegulltë. Uli kokën e duke u rënë njerëzve me bërryle u largua duke ckërmitur dhëmbët. Këmbët i hiqte zvarrë e pështynte papushim. I dukej vetja si në ëndërr. Edhe këtë s'e priste.

Ishte mekur nga vështrimet e zjarra e plot qortime të punëtorëve. Kishte djersitur e gulçimat po e mbysnin. Një rrudhë e thellë i qe shfaqur në ballë e në atë rrudhë i qe shënuar një farë zemërimi dhe pendimi. «Po, shokët kanë të drejtë». E gjeti këtë fjalë në sytë e shokëve të kantierit, në fletërrufënë e shokëve të tij të ngushtë dhe filloi ta ndiente thellë dhe fort se duhej ndërruar rrugë sa s'qe vonë.

«Po shokë, unë do të jem me ju, në ballë.» Nuk i tha me zë, por qe një betim i brendshëm, i fuqishëm që ia shprehën sytë e veshur me lot.

VAJZA JONE

Megjithëse jashtë bënte ftohtë dhe ta kishte ëndëtë rrije në diell, brenda në sallë, ishte vapë dhe dikush u ngrit e hapi dritaren në të dy kanatet. Menjëherë ajri i ftohtë hyri në sallë e të gjithë ndjenë flladitje. Tymi i duhanit u shty e u dynd në dritare dhe një copë herë dritarja tymoste si oxhak.

Dita po shtyhej pa u ndierë dhe askush nuk pyeste për orën, asnjë nuk kërkoj të bëhej pushim me gjithëse kishin kaluar dy orë nga pushimi i parë, duke shkelur kështu rregullin që ishte vendosur, që çdo një orë e gjysmë të bëhej pushim. Fjalën e mori një vajzë, brigadierja e brigadës së dytë. U ngrit u ra flokëve me dorë duke zbuluar tërë fytyrën, ktheu sytë në fillim nga dritarja e hapur e pasi pa nga presidumi, u mbush me frymë e nisi të flasë:

Në brigadën tonë ka më pak krahë pune se në brigadën e Dules, por planin e grurit, të fasules e të patates i realizuam. Këto ditë përfunduan edhe një hektar qilizmë, edhe plehun e shpumë në parcelë sipas grafikut. Kam katër vjet që po bëj nga katër-qind ditë pune. Këtë vit them të bëj edhe ca më shumë, po jo vetëm unë po edhe anëtarët e tjerë. Këtë përgjigje i jap Dules unë, — iu drejtua një burri hijerëndë që rrinte dy rreshta përpara saj.

Fshatarët lëvizën dhe e kthyen kokën nga Dulja,

brigadier i brigadës së tretë, i cili pak më parë kishte bërë një farë apologjje dhe s'kishte mbajtur asnjë të metë përsipër. Dulja ngriti kokën ngadalë sikur ta lëvizte brenda zgjedhës dhe hodhi shikimin e ftohtë mbi Manushaqen. Atë çast u vrenjt e sikur u shëmtua disi.

— E de, se e morëm vesh punën tënde, — filloi Dulja me zë të shtruar e të thellë. — Po pse s'na thua ç'tokë ke ti e ç'tokë kam unë. Brigadës së dytë, i ka rënë tokë e mirë, këtë s'e fshehim dot, prandaj e ke edhe gojën brisk ti, — i tha këto fjalë me një ton ironie. — Ja si éshtë puna, — u kthyesh përpara. — Dheu s'éshtë një kudo, këtë e dinë edhe kalamanët... I ka rënë tokë e butë, e majme, e ronitur brigadës së dytë, ama në na ra në hisë tokë e verdhë, me çehre prejt të vdekuri, tokë «mashkull», ja, kështu, s'e fshehim dot, tokë që të pëlcet buzën!

— Ç'i ke këto, ore Dule... Hajt se poi i këmbejmë, — brofi Manushaqja e indinjuar. — Jo, jo, nuk i gjelltit këtë profka ne, hajt t'i këmbejmë e të shikojmë së kush e ka fajin, — përpëliti qerpikët dhe gjoksi i bëri hov përpara.

— E po kështu éshtë, moj, përsë ha kondra!

— Dale, dale, se s'je në brazdë, o Dule, — u ngrit Vaska, një djalë i gjatë, i thatë e me një hundë si sqep shqiponje, që gjer atë çast s'kishte hapur gojë. — Unë jam kundra Dules, nuk ia hedh fajin tokës... Vërtet që dheu s'éshtë një, ama që të thuash këtu tokë mashkull e tokë femër, jo de, këto fjalë s'thuhen, merri prapa, e mos na shit mend këtu! Do të çuditim edhe këta të deleguarit e rrëthit. Pse, o Dule, s'na thua këtu kur dilni në punë, se më dhjetë nuk dilet, de!... Këta të brigadës së tretë, o shokë, — hapi pëllëmbët Vaska, — ia shtrojnë me muhabet e me duhan si në ditë das-

me, e po kështu, mashkull e shkuar mashkullit do të
na dalë tokë. Bjeri në kokë, Dule, mos na sill rrrotull
si kalin në vra!

Dulja befas shkrofëtiti e tundi kokën. Fjalët e
Vaskës i kishin vënë flakën e pa ua vënë veshin ro-
muzeve që hidhnin njerëzit në sallë, picërrroi sytë e u
mat të fliste, por atëherë salsa gumëzhiti e nuk e lanë
të hapë gojë. E vunë përpara Dulen.

— Ta dëgjuam këngën!...

— Lëri profkat, Dule.

— S'të shkojnë këtu, në ke për të thënë ndonjë
fjalë të saktë, mirë, përndryshe, ulu dhe vëri gishtin
kokës, — shtoi Vaska në mes të zhurmës.

Presidiumi s'po vinte dot rregull. Dulja kishte
ndezur sherrin, kishte shitur ca përralla që s'i besonte
as ai më i humburi.

— Epo s'jemi në pazar, de, — u dëgjua zëri me-
talik i Ridvanit. — Do të më lini të them nga dy fjalë,
apo...

— Prisni të dëgjojmë Ridvanin, — thirri nga pre-
sidiumi sekretari i organizatës së Partisë. U bë hesh-
tje. Ridvani shkriftoi grykën, rrrotulloi kokën e kaf-
shoi majën e mustaqes. Ai kishte një fytyrë eshtake
por të qetë, me ca vetulla të trasha, kaleshe, me një
mjkër katërqoshe

— Ja ç'dua të them unë, — nisi Ridvani. — Pleqtë
na e kanë lënë një fjalë me mend: «S'ka faj toka po
ka faj koka». Prandaj unë them të na e shkruajë me
shkronja të mëdha mësuesja e ta vemë parullë, besa-
-besën ta vemë parullë. E dashka puna ta bëjmë
kështu, se sa për krahët, njësoj i kemi, duar unë, duar
ti, ama kur vjen puna edhe plisat u dashka t'i thërr-
mosh me pëllëmbë, pa mos druani, se nuk u hahet
lëkura. Ja kështu them unë.

Kaq foli Ridvani e u ul me zhurmë në stol.

— Të lumtë goja, Ridvan, — u ngrit një zë nga mbledhja.

Tek po e vështroja Manushaqen, ndieja një si ckërmitje përbrenda, një farë kërshërie. Fytyra e saj, më shëmbëllente me dikë. «Se ku e kam parë këtë fytyrë?» Edhe fjalët e saj, të thjeshta e konçize po më nguleshin në kokë. Kur fliste, sepse i trazohej fytyra herë nga një ngjyrë e bardhë, herë e trëndafiltë.

Manushaqja kishte sy të bukur e të butë në formë bajameje, ngjyrë kafe e pak të turbullt, si sy mëshqere, ndërsa qerpikët e gjatë e të dendur, i lëshonin hije mbi mollëzat e faqeve. Goja e vogël e buzët pak të përveshura, i jepnin bukuri. Fytyra e saj më atë push të lehtë e pa ngjyrë, e rrahur nga era e thëllimi, e pjekur nga zhagu, sepse të ndillte e të jep-te një gëzim të lehtë, gati fëminor. Dhe ndërsa e soiditja këtë fytyrë mikluese, vrisja mendjen e sepse më dukej se e kisha parë edhe më parë këtë njeri. Befas kryetari i kooperativës më ra me bërryl.

— Të kujtohet Çikoja, ai plaku që e kishte shtëpinë në buzë të lumi?

— Ai plaku i mirë ku fjetëm atëherë, kur hapëm shkollën e parë?

— Ja, kjo është e bija!...

Më shpëtoi një zë i lehtë. Kujtimet më brodhën larg, në vite, më rrodhën si ujë i kroit.

Ishin vitet e para të pasçlirimit të atdheut. Këto fshatra këtej, ishin jashtzakonisht të varfëra e të prapambetura. Atë vit fshatarët apo kishin marrë tokë nga Reforma Agrare por frytet e saj ende nuk i kishin korruar. Një ditë, me një ekip, erdhëm në këto anë dhe do të hapnim shkollën e parë.

Qëndrova në një faqe mali. Isha i lodhur, kisha

uri, etje, s'kisha as duhan. Mbështeta shpinën te trungu i një lisi dhe e humba shikimin në atë peisazh të egër e të bukur. Pak më vonë u nisa e mora dhiaren te poshtë, drejt lumit, kur në zall shoh një gjë të zezë që lëvizi e u zhduk. Ndonjë bishë, mendova. Bëra edhe dësa hapa më tej, përsëri diçka lëvizi midis shku-rreve. Vura dorën në armë dhe prita një çast, por për çudi, midis gjetheve të shkurrez, pashë një njeri! Ishte një vajzë nga dhjetë-dymbëdhjetë vjeç. Ajo qe ngurosur e po më vështronë me një sy të turbullt. Në duar i dridhej një bucë. Iu afrova, ajo u zmbraps.

— Pse ke frikë, — e pyeta.

Nuk m'u përgjigj. Vajza me bucëlen ndër duar më vështronë me frikë. Pamja e saj qe e egër! Flokët e paprerë e të pakrehur i binin mbi shpatullat, mbi fytyrë e mbi gjoks, të drejtë e të gjatë, fytyrën e kishte krejt pa shprehje, naive, buzët pak të përveshura, hunda e vogël. Sytë e turbullt, por të butë e të përhumbur, s'm'i ndante. Trupin ia mbulonte një gjysmë fustani apo këmishë ushtarake, as që merrej vesh, në ngjyrën e dheut.

— Më jep pak ujë, — i thashë.

Përsëri ngurroi, por pak më vonë më zgjati bucëlen. E ngrita dhe piva me etje. Kur ia ktheva bucëlen m'u duk se bëri buzën në gaz dhe iku menjëherë gati duke rendur.

— Prit, mos ik, — i thirra.

Por ajo hidhej si një sorkadhe mbi gurët e zallit. Në një farë vendi qëndroi e ktheu kokën, por sa u nisa ti vete pranë ajo më fluturoi. Mora përsëri udhën e pas pak arrita në fshat. Përpara një kasolleje gjeta shokun tim, i cili po bisedonte me ca fshatarë. U përshëndetëm dhe drodhëm nga një cigare.

Pa e mbaruar cigaren, ai më i moshuari, një burrë i thinjur, i thatë si shkarpë e pak i kërrusur, na mori për në shtëpinë e tij.

Nuk dinte si të na nderonte meqë bujtëm tek ai. Ishte i gëzuar që i kishim vajtur në shtëpi, kurse ne ishin të prekur thellë nga bujaria e tij. Ndejtëm gjer vonë atë natë duke biseduar. Gjithçka na dukej se shkonte për bukuri dhe se shkolla do të hapej, se vështirësitë po i kapërcenim. I zoti i shtëpisë na e kishte dhënë fjalën se të dy djemtë do t'i dërgonte në shkollë ndërsa vajzën.

— Edhe vajzën, nuk ka si bëhet ndryshe — ngulte këmbë shoku im.

Befas i zoti i shtëpisë u vrenjt dhe shikimi iu turbullua. Ndryshti i plakut na erdhi krejt i parritur.

— Duhet të kuptojmë e të bindemi se shkolla ka rëndësi të madhe e ajo s'mund të hapet po s'dërguam ne fëmijët tanë, — i thashë.

— Nuk i lipset shkolla vajzës... Djemtë hajde, po vajzën qysh ta le? — tha me gjysmë zëri plaku, e tundi kokën me mosbesim. M'u duk se atë çast diçka e shtrëngonte në fyt, diçka i rëndonte mbi supe.

Duhej t'ia nisnim nga fillimi. Ai s'po vendoste, lëkundej, dhe në qoftë se ne do të pranonim të mos e dërgonte vajzën në shkollë, do të na shthurej «gardi». Jo ai duhej të bindej, ai duhej ta hiqte rrugën i pari, ai pat qenë i lidhur me Luftën, ai s'kishte kursyer asgjë për partizanët, ai ua kishte hequr bukën nga goja fëmijëve e ua kishte ndarë partizanëve. Si mund të na e kthente tani ai?

— Dashke ta lesh vajzën qorre tërë jetën? Djemtë e vajzat i ka njëlloj Partia jonë. A s'ka pasur në luftë vajza që kanë luftuar njëlloj si djemtë. Kjo e

vërtétë nuk do tē harrohet kurrë, kjo do tē mbetet
në histori, → i thashë me një farë zemërimi.

Plaku ngriti kokën, u përcoll por ishte akoma i
topitur në mendimet e vëta.

— A mund t'ia kthejmë ne fjalën Partisë, — pyet-
ti shoku im.

— Nuk ka bir néné në këto anë që t'ia kthejë
fjalën Partisë, ama vajzën lëreni, c'i duhet shkolla
asaj, qysh ta le... C'do tē thotë fshati?... Qysh e bëri
Çikoja, do tē thonë, do tē më marrin nëpër gojë!

E patëm mjast tē vështirë, biseduam për orë tē
tëra, por pas mesit tē natës na u duk se e bindëm.
Ramë tē flnim. Ai s'kishte gjumë. U ngrit disa herë
dhe vështronë nga dritarja. Një herë hapi portën
dhe qëndroi në hajat. Atje flinin fëmijët. Ai i vësh-
tronë me habi dhe mua më dukej se tërë merakun e
kishte te vajza. Në mëngjes, kur na përcolli, na tha:
— Do t'ia shkrepë edhe Çikoja!

Pas disa ditësh shkolla u hap. Por atë ditë plaku
nuk doli fare nga shtëpia. Rrinte ulur te gardhi e
pinte duhan. Herë pas herë ngrinte bucelen e lagte
gojën me ujë. Shikimin s'e hqte nga zallit, përtëj
lumit, tek ajo ndërtësë e vogël e lyer me gëllgëre. Atë
ditë plaku që si mbi ujë; gjuha i qe lidhur, sytë i
përshkëndritnin e gjaku i vlonë.

Kur u kthye vajza, plaku u step. Nuk e kuptonte
ç'qe ai gjësim që kishte ajo. Abetaren e fletoret
i shtrëngonte më tē dyja duart, por kur ndeshi shiki-
min pa shprehje tē tē atit u step. Befas plaku ia mori
librin, e vështroi me habi, tundi kokën e iam ktheu
me një rënkim tē lehtë, por që vajzës iu duk sikur
i tha «Për hair tē qoftë!»

Vitet kishin shkuar dhe ajo vajza dhjetëvjeçë
që më pat dhënë ujë me bucelen që rritur. Një gjësim

i papërmabjatur me kishte përfshirë të gjithin. Po si mund të mos të rrahë zemra pér këta njerëz? Tani duhej të merrnin shembull nga Manushaqja, e këtë shembull duhej ta merrnin burrat, Dulja.

Por Dulja qe edhe sedërli. Qe bërë spec në fytyrë dhe nuk e mbante vendi, duart i lëviste me ner-vozizëm e pinte duhan pa pushim. Manushaqja i kishte propozuar të këmbezin tokat!...

«E kush se, e bija e Çikos!... Posi, të ngrihet e ta bën lëkurën copë. Doemos dikush e mëson. Nuk janë llafet e saj këto, jo! Pa të hedhin edhe romuze! Bah, u bëra pesëdhjetë e kusur vjeç burrë, por s'ma kishte përfolur njeri llafin... Po këta gojacët e brigadës sime si e kanë hallin? Në baltë do të më lënë? Doemos, fajin e kam vetë, i kam lënë të shtrihen e tani më kthejnë krahët. Hajt, pa do ta shikoni Dulen!»

Dulja shtrëngoi dhëmbët, ngriti kokën e ndeshi shikimin e Fates, një i ri i brigadës së tij. Fatja po matej të ngrihej. Befas një shkëndijë shprese i cërriti në zemër Dules. Zgjati kokën përpara.

— Ma jepni fjalën, kam nja dy fjalë edhe unë,
— tha Fatja.

— Qetësi, shokë, — thirri kryetari i kooperativës.

— Që ta themi troç, — ia nisi Fatja, — brigada jonë e ka qulloSUR fare këtë vit. Ja unë, ç'kam futur unë? Dyqind norma gjithsej, ama si unë ka edhe të tjerë. Turp është, turp sa s'ka ku të vejë, po këtu s'duhen llafet; ja, do t'i vë detyrë vetes që këtë turp ta laj me punë. — Dules i shkoi një drithmë, diçka iu përbys përbrenda. — Dhe, — Fatja ia nguli shikimin Dules, — Dulja bën një gabim të dytë, që nuk do t'i pranojë të metat. S'kishte hiç të drejtë kur foli ashtu. Nuk ka tokë mashkull, po ka organizim të

dobët, ka lëshime, s'ka kërkesë llogarie e s'ka shembull personal. Këtu është e keqja jonë. Dulja duhet të shkundet e të pranojë një për një të metat.

Fates i ndritën sytë, ftyra iu çel dhe si ndenji një copë herë pa folur u ul. M'u duk se ai njeri shkarkoi një brengë.

— Më duket se i ra problemit në kokë, — i thashë sekretarit të Partisë, të cilin e kisha në krah.

— Vërtet, në kokë i ra.

— Me leje, — u ngrit një dorë nga fundi i sallës.

— Folë!

— Unë jam i një mendjeje me Faten, po unë dua të shtoj edhe diçka tjetër, — tha një djalë ziosh, topolak e me ca krahë të shkurtër. Quhej Nasib. — Dulja ka edhe një të metë tjetër. Ai s'i përfill propozimet tonë. Ja, për shembull, kur ishte puna për të hapur kanalin e ujit, ne e menduam ta bëjmë aksion të rinisë, kurse ai na e preu: «Prisni, të na vijnë forca nga brigadat e tjera pastaj t'ia nisim.»

Këtë herë Dulja nuk duroi më dhe brofi më këmbë:

— Ti, more Nasib, mos i trego babait arat!

— Léri zënkat, o Dule e na thuaj, a janë të vërteta këto që ngrihen këtu? — pyeti Ridvani.

— Sa për punët e bujqësisë, unë i di më mirë se Fatja e se Nasibi, po hajt, kush u zemërohet këtyre, i riu si veriu, pa në s'ju pëlqej si brigadier, hiqmëni, unë s'ju thashë kur më vutë! Posi, po qe se tërë faji rënka mbi mua, hiqmëni se s'bëhet qameti; — shfryu Dulja me zemërim.

— Dëgjo këtu të të them edhe një fjalë, o Dule, — shtoi Ridvani. — Punët e bujqësisë i dimë ore, po ti je si ato bletët sertë. Manushaqja është bletë e shtruar, e mbush piten më mirë se ti e se unë!

Në sallë kishte rënë qetësi, po një qetësi e rremë, se kooperativistët s'ishin hiç të qetë. Dulen e shikonin me inat e me keqardhje.

Dulja s'ngrinte kokën... Inati po e gjerryente përbrenda.

«Bah, se kush i mëson pa flasin kështu! «Ky mendim sepse po i fiksohej gjithnjë e më tepër në kokë». Po si nuk doli asnijë e të më mbante anën, xhanëm? Pa le, po edhe Ridvani, pa shiko se si u vajtka pas ujërave këtyre të rinisë? Jo de, s'e bën burri këtë punë... Mirë de, le të ma ngjitin brigadë e prapambetur, ç'më gjeti mua. Po ajo spriha, si tha ashtu? *Hajt t'i këmbejmë...*»

Dulja, ngaqë s'kishte ç'të bënte ndukte qillotat, kruante kokën, kafshonte buzët. Kishte disa çaste që i dukej vetja si në èndërr. Tundi kokën e ngjeshi kapelen. Por ai nuk e merrte vesh se s'kishte të bënte vetëm me Manushaqen, e, ndonëse këta të tjerët kishin folur «çapraz» ishte i sigurt se të nesërmën në mbledhjen e brigadës do të flisnin ndryshe, atje e dinte vetë Dulja si t'ua mblidhët vidat.

Hodhi shikimin nga presidiumi. «Pse s'e kanë vënë edhe në presidium atë, sprihën, xhanëm?»

Dulja turfullonte. S'donte të besonte që Manushaqja i kishte të sajat ato fjalë që tha. Për Dulen ajo qe e bija e Çikos dhe kaq. Por vajza i kishte çelur sytë si ato lulet e pranverës pas dimrit të gjatë. Kush më shumë se ajo kishte marrë pjesë në aksionet e rinisë, në hekurudhë e në tarracat e Jonufrit? Kush kishte marrë në shkollën bujqësore nota më të mira se ajo? Kush e kishte më të pasur raftin e librave? Kishte plot burra të urtë në fshat që nuk u binte nuri kur e pyesnin Manushaqen edhe për plehrat kimiike, pse jo, edhe për farërat e grurit. Manushaqja

shpeshherë, në pushimet e shkurtra, nxirrte nga torba e bukës ndonjë libër e ua lexonte anëtarëve të brigadës, u tregonte për zhvillimin e bimëve në etapat e ndryshme, u tregonte pse duhej bërë ky ose ai shërbim. U ngritën dhe të tjerë dhe folën, i ranë në kokë Dules dhe vlerësuan punën e palodhur të Manushaqes. Dulja s'bëhej për të gjallë ndërsa Manushaqeja ishte skuqur në fytyrë. Shaminë e qafës, një shami aksioni e kishte hequr nga qafa dhe e mbante në dorë, njëherë e lidhte nyje, një herë e zgjidhë.

— Ky është problem me rëndësi dhe unë mendoj të bëjmë pushim. — tha kryetari. — Le të mendojë Dulja dhe të ketë kurajo e t'u flasë shokëve me zemër të hapur. Kështu mendoj unë, shokë. Kësaj brigade i do gjetur dermani se edhe ne shokët e kryesi-së, fajin me torbë e kemi. Hë de, lëvizni ca, pa shiko se si na del puna. Jo ore, unë them, hiç të mos kemi të prapambetur, të gjitha brigadat t'i vemë më një sërë.

Zemërimi iu ul pak Dules. Propozimi i kryetarit iu duk me vend. E ndiente që kishte nevojë të mblidhë veten. Tëmthat i rrini me forcë. Tundi kokën e nxori kutinë e duhanit.

* * *

Kur po dilnin kooperativistët nga salla, ndeza një cigare. Manushaqja diçka po bisedonte me Ridvanin dhe iu afroan Dules që kishte humbur në tymin e duhanit, po kur ktheu kokën e ndeshi shikimin tim u skuq. Pa vetëdije bëra disa hapa përpëra e i shtrëngova dorën. Drita e syve të saj ishte po aq e

butë, e turbullt, si atëherë, tamam si drita e syve të një mëshquerre.

— Të lumtë Manushaqe, — i thashë, — je bërë shembull për të gjithë kooperativën.

Por ajo nuk fliste, vetëm më shikonte e buzë-queshte, ndërsa njérën dorë e kishte mbështetur te shpatullat e gjera të Dules.

Në ato çaste, mendja më fluturoi larg, në vite, te ajo buzë lumi, tek ajo vogëlushja e frikësuar që më dha ujë me bucelë atë ditë vjeshte.

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...

...</

PRITA NË SHPELLË

Dielli ende s'kishte dalë kur Kasoja, punëtori operativ vajti te kroi për të larë sytë. Kur kishte rënë, gjumi s'i ngjitej në sy, ndonëse qepallat i rëndonin. Ishte përpjekur tërë natën e natës se koskat i dhimbnin dhe shputat e këmbëve i digjnin nga lodhja. Kurrë ndonjëherë s'kishte pasur aq punë, kurrë ndonjëherë s'kishte nxituar aq fort. Ngjarjet kishin rrjedhur papritur, shumë plane qenë prishur e, aty për aty, ishin sajuar plane të reja, kurthe të reja. Ndjekja vazhdonte.

Punëtorin operativ, gjumi e kishte zënë ndaj të gdhirë, por edhe ato dy orë gjumë, i kishte bërë copa-copa e me mendje të ngritur. Uji qe i ftohtë ujë mali. Vuri zverkun te lugu i drunjtë dhe e fërkoi me pëllëmbën e madhe, piu edhe dy gérqe e u kthyte në kasolle duke shkundur duart. Uji i ftohtë, i kullonte në gjoks e ca pika të ndritshme, si të praruara, i kishin mbetur midis qimeve të kuqe të gjoksit të gjerë.

— Ç'e bëtë atë copë peshqir, o djem?

Gëzimi, lëvizti në shtratin me kashtë fieri e u kthyte në krahun tjetër, ndërsa Bujari hapi sytë e gogësiti.

— Shiko gjumashët, s'tunden nga vendi!... Hajt, ore, çohuni e më nxirri peshqirin.

Gëzimi brofi e zgjati një copë peshqir që e kish-te vënë nën kokë, në vend të jastëkut.

— T'u vraka faqja, ty? — ia priti me shaka pu-nëtori operativ.

Gëzimi qeshi, hapi krahët e gjatë e bëri ca lë-vizje të trupit.

— Hajt ore, më ndërro këtë pambukun në faqe se e laga pa në do të më përdridhesh, dil jashtë e bëj ç'të duash.

Qielli në lindje ishte bërë gjak i kuq. Një puhi-zë e lehtë, dredharake, zbriste ngadalë si e përgju-mur, nga bjeshkët, uji te kroi shkëlqente dhe e mbush-te livadhin me gurgullimën e tij të këndshme. Era e stanit, erë qumështi, leshi e mbeturinash, vinte pak e athtë. Kasollja, vatha dhe era e stanit i sillnin kuj-time, e ndillnin e përmallonin Kason. Diku mbi një shpat mali, kullosnin tufat e dëgjonin tringëllimat valë-valë të zileve e të këmborëve që ia ndiznin akoma edhe më shumë mallin e i zgjonin kujtimet e fëmi-jërisë.

— Të qan syri për bjeshkët, o Kaso, tha padashur Gëzimi.

— Më qan, o bir... më qan për tufën, për stanin, për qenin për erën e trëndelinës... Është vendi im ky, më dhemb, e dua se më ka rritur me thërrimet sofrës, më ka rrahur me thëllimin e dimrit, pa më ka djegur edhe me zhegun e beharit. Vite rrojta këtyre anëve me ato tufëzat e buta... S'e di ti ç'është tufa, as sisën e deles s'e di ti. Kur t'i qërojmë këto plehra, do të vi të rri ca ditë në stan, do të çmallem e do të çlodhem.

Gëzimit i qe mbushur fytyra plot drithë tek dë-gjonte Kason që përgjërohej për ato bjeshkët.

«Edhe ky ka ëndrrat e tij» — mendoi.

Mbi zverk ndjeu pëllëmbën e ashpér të punëtorit operativ.

— I thosha djalit: «Mos harro q'ka qenë yt atë!» Edhe ti, o bir, mos harro q'kemi qenë, — pëshpëriti Kasoja me sytë gjysmë të mbyllur.

Bujari tundi kokën e qeshi pa zë, e duke hedhur çantën në shpinë tregoi se ishte gati pér udhë.

— Nuk do të hamë një çikë bukë? — pyeti me zë të zvargur Gëzimi.

— Mendjen te buka e ka djali, o Bujar, — qeshi me zë Kasoja duke ia shkundur supin Gëzimit. — Lere të hajë se pérndryshe do të na çajë kokën tërë ditën, ha edhe ti, ore, mos prisni t'ju jap leje në këtë punë. Unë pér vete s'dua, s'ha dot që pagdhirë, — e duke ndezur cigaren, vajti u ul mbi koritën e drunj-të ku pinin ujë dhentë.

— Ha ca dhe ti, shoku përgjegjës, nuk niset njëriu me barkun bosh, — i tha Gëzimi Kasos.

— Në moshën tënde, o Gëzim, njeriu ha me qejf, — murmuriti Kasoja duke zhytur majën e këpucës në ujë e duke rrahur gishtat e dorës mbi gju si të ndiqte ritmin e një melodie.

Nuk e kishte mendjen aty, dukej se e kishte rrëmbyer horizonti i përflakur në lindje. Fytyra e madhe, pak e shtypur e parruar prej një jave, po i merrte dalngadalë një vezullim të lehtë nga drita e diellit që kishte filluar të derdhej majave të maleve. Flaku cigaren, lau gojën me një dorë ujë dhe hodhi automatikun në krah. Bujari brofi dhe Gëzimi ia lidhi grykën çantës.

— Gati, djema?

— Gati, — u përgjigj Bujari.

Gëzimit sepse iu duk sikur ai foli përgjumësh, e ia priti:

— S'i ka dalë gjumi akoma Bujarit!

Bujari, vërtet s'kishte hapur gojë atë mëngjes, por ashtu ishte ai, i kishte fjalët të pakta. Bujari, si edhe Gëzimi, ishte i ri në këto anë, s'kishte as dy muaj që kishte ardhur në Veri. Më parë kishte shërbyer në repartet e kufirit, në Jug, ku ishte plagosur dy herë. Ishte nja tridhjet vjeç, tamam në kohën përmartesë. Edhe njerëzit e shtëpisë s'e linin rehat, s'kishte letër që të mos ia zinin në gojë nusen... Por detyra, lëvizjet e shpeshta, bandat e diversantëve, e dasma shtyhej padashur. Ai e dinte se pleqtë te ai e kishin mendjen e tanit që kishin një vit pa e parë, kushedi se sa do t'i kishte zënë malli. Motrat ishin martuar e shtëpia kishte mbetur bosh, po ku ishin mësuar pleqtë pa njerëz. Këto mendonte sa herë që shkruante letra, por mendimet e tij më tepër rrithnin te bjeshkët, te shpellat ku fshiheshin banditët.

Bujari qe mësuar me jetën e ashpër të ndjekësit, i pëlqente, kishte gëzime dhe emocione kjo jetë. Sa banda diversantësh ishin asgjësuar ato dhjetë vjetët e pasçlirimit! E përsëri bânda të tjera, lëviznë natën, përdhosnin tokën, kërcënoin e vrisin njerëz, grabitnin bagëti dhe u kallnin flakën shtëpive të komunistëve. Ngjarje të tillë, ia hidhnin zemrën përpjetë Bujarit dhe betohej në heshtje se nuk do të kthehej në shtëpi pa i qëruar këto plehra.

Urrejtja përmë armikun e klasës i qe mbledhur në gjoks dhe i digjte si zjarr në krahëror. Kur u shpëtonte ndonjë kriminel, atëherë bëhej edhe më i heshur dhe rrudhëzat anëve të syve i mblidheshin edhe më shumë.

Kasoja udhëhiqte treshen në ca monopate e limore të pashkelura. Automatikun e mbante në dorë e me sytë e kaltër e të lbyrur kontrollonte pa pushim malet. Trupi i tij i ngjeshur, me shpatulla të gjera, me atë qafë të shkurtër e të fuqishme, dukej akoma më i rëndë kur shkelte, ndërsa këpucët i fundose-shin në gjethet e kalbura duke bluajtur shkarpa të thata. Në brez i tundeshin e i rrithnin ijet granadat, që i shkisnin përpara, por vetëm kur ulej e kur i binin mbi bark i shtynte prapa. Kur ecte nuk fliste, por atë mëngjes jo vetëm që qe bërë i heshtur por edhe i zymtë. Sytë i mbante fare të mbyllur dhe herë pas here rregullonte kasketën me strehë të gjatë. Diku, në një farë rrëzomë, kapi degën e një ahu e befas qëndroi, ngriti me gisht strehën e kasketës e tregoi me dorë:

— Ja lugina! Të duket sikur hodhe këmbën e vajte, po e do një orë udhë. Andej duhet të kalojnë, se pse s'e besoj t'u jetë mbushur mendja t'i dalin shpellës nga ana tjetër mbasi do të vonohen... le që andej do të thyejnë këmbët nëpër shkëmbinj!... Sidoqoftë ne kemi avancuar më shumë, do t'u dalim që sipër e do t'i presim si duhet.

Zëri i Kasos i qetë e i ftohtë, kishte një siguri të atillë që s'të linte të mendoje ndryshe, ndërsa Bu-jari shtoi:

— Ju thatë se mund të shkohet edhe nga anë tjetër?...

— Nga të duan le të shkojnë, ne do të mbërrimë përpara tyre, njoftimi i fundit na thotë se ata s'kanë lëvizur, pra ende s'janë ndeshur, përgjojnë e bëjnë

planin e daljes nga rrëthimi. Po mundi të dalë ndonjë, do të vijë këtej shumë kohë pas nesh. Sa për atë që pyet ti, o Bujar, shkohet edhe nga ana tjetër po mua ma thotë mendja se s'do të dalin në luginë, kështu më bie erë.

— Të nuhatësh manovrimin e armikut thuaj se e munde, — foli me gjysmë zëri Gëzimi.

Punëtori operativ këputi një gjethë ahu dhe e vuri në buzë. Gëzimi kishte vënë duart në ije e qëndronte këmbëhapur duke soditur luginën që ishte një rrip luadhi i blertë e i ngjeshur midis maleve të larta e të pjerrta, si thikë. Dicka i kujtonte ai peisazh, po nuk e sillte ndër mend ose më mirë s'e bënte dot krahasimin... Ai kishte lindur e qe rritur buzë detit, andej ku malet ishin të ëmbël e ku deti dukej si quell. Gëzimi e njihte mirë detin, rrudhëzat e dallgët, ia njihte edhe erën e stuhinë, kishte mësuar të maste edhe largësinë e anijeve, u binte rremave e voziste me shkathtësi, njihte edhe flamurët e anijeve, ndërsa bjeshkët, humnerat e luginat, kishin dicka të vëçantë, të panjohur për të.

— Kjo është ajo lugina e famshme? — pyeti që prapa shpinës së Kasos.

— Kjo, o bir... Eh, c'dimër i tmerrshëm vajti! Hedh shumë dëborë dimri në këto anë. Le pastaj stuhia, sa e fuqishme, tamam sikur nga lugina dalin erërat e maleve! Edhe egërsirat s'qëndrojnë dot, po zbresin poshtë.

— E megjithatë ju kaluat nëpër luginë, — kujtoi Bujari.

— S'kishim tjetër rrugë. Gjermani qe hapur shumë, ballistët u tregonin udhët... Do të kishim vdekur që të gjithë në dëborë po të mos zinim shpellën. Eh, more djem, q'u ra ndër mend ai dimër! — psherëtiu

Kasoja, kafshoi buzët e trasha e uli sytë. Atë ditë kur u kishte treguar për luginën, sa kishte zënë në gojë emrin Lekë, e kishte ndërruar fjalën, s'e kishte mbaruar tregimin. Kjo iu kujtua mirë. Flaku gjethën e ahut, fërkoi vetullën e majtë dhe vazhdoi tregimin e lënë përgjysmë.

Bëmë ç'kishim në dorë, por... — preku lehtë plagët në faqe. — Në shpellën ku do të shkojmë kemi varrosur Lekën! Qe një zhevahir djalë, e mbaja, në shpinë, por s'ia zinim dot gjakun e na vdiq në duar... C'të kujtosh më parë!

Kasoja u vrënjt, pastaj befas i dha gjoksit përpara.

— S'është aq e frikshme ydekja, o djem, tjetër punë se të le vragë në shpirt.

— Kush vdes për atdhe... — s'mbaroi fjalën Gëzimi.

— Ashtu, bir!... Leka rron! Më duket sikur do ta gjej në shpellë e do të kuvëndojmë me të.

Ruante mbresa të pashlyeshme Kasoja dhejeta në bjeshkët e heshtura e netët pa gjumë ia përkundnin në sytë e mendjes rrjedhën e viteve të largëta. E treti shikimin mbi luginë një copë herë. Dielli sapo kishtë kaptuar majën e malit mbi shpellë, e drita e tij që derdhur mbi pyjet dhe po e treste mjegullën mbi luginë. Në një kënd të qiellit, një re e bardhë si shkumbë, rrinte pezull ndërsa qielli shkëlqente me një kaltërsi të xhamtë. Një oshëtimë e mbytur vinte pa pushim nga lugina. Qe zhurma e përroit që derdhej prapa shpellës.

— Ku është shpella? — pyeti Bujari.
Kasoja qeshi, me atë të qeshur të ëmbël që ta përkëdhelte zemrën.

— Mbi luginë e ke, në zemër të këtij mali që ke përpara, por s'e gjen dot me sy.

Disa caste gjithçka përreth heshti, edhe pérroi e pushoi oshëtimën, edhe tufa e dhenve nuk dukej më, ndërsa lugina i tërhiqte poshtë, i ndillte në gjirin e saj e Kasoja në krye e dy të tjerët pas, po zbrisnin pyllin mes për mes ahishtes.

— Ja edhe lugina, mbuluar me bar të njomë e me lule dele, lule kaçe e poleska.

— Mos lini gjurmë, — bëri me kokë Kasoja andej nga buronte ujët.

Ta kishte ënda të rrripe e të shtriheshë në atë livadh. T'i merrte sytë shkëlqimi i vesës e të deh-nin aromat e barit e të luleve. Gëzimit iu kujtua deti. Por «det» të tillë s'kishte parë kurrë, s'i kishte thithur kurrë këto aroma, as këtë ajër, s'kishte parë kurrë vesë aq të ndritshme. Vetëm perëndimet e diellit s'i gjeje asgjékund më të bukur se në det. Gëzimi u përmend nga zëri i Kasos.

— Shpejt, djema, s'është vend për të ndenjur këtu.

Kur ngriti kokën Gëzimi, Kasoja po i varej fakes shkëmbore. Për habi të tij, ai kërcente si lepur mbi gurët, u kacavirrej shkëmbinjve me këmbë e me duar e trupi i rrumbullaktë i lëvizte me shkath-tësi. Pesëdhjetë vjeç ishte Kasoja, por ishte i shpejtë e i zhđervjellët sa t'ia kishe zili. Edhe Bujari s'binte poshtë, ishte i shpejtë e i lehtë e nuk e kishte zor në të përpjetë, ndërsa Gëzimi e kishte më të vështirë, nuk e zgjidhët mirë vendin, s'ishte mësuar me gërxhet e po të mos kishte fuqinë e djaloshit një-zetvjeçar, do të mbetej prapa, s'do të arrinte me kohë në shpellë. Kur shkelte mbi ndonjë gur dhe

e rrokulliste prapa me zhurmë, Kasoja kthente ko-kën e i tundte gishtin:

— Kështu na prish punë, o bir, apo s'e vë re se guri i shkûlur le shenjë?

Gëzimi pështynte nga inati tërë dufin ia nxirr-te çantës së shpinës dhe herë pas here e godiste me bërryl. Ndryshe qe të bëje not në det. A ke fuqi t'u japësh krahëve e këmbëve? Ndërsa ngjitja s'dashka vetëm fuqi.

Dihaste e fshinte ballin e dirsur me mëngë. Iu tha goja, pëllëmbët i digjin, i qe zhvoshkur lëkura, zverku i përvëlonët nga dielli e sytë ia vrisnin gu-rët e bardhë si gëlqere. Pa Kason që qëndroi në një farë vendi e ngriti kasketën.

— Edhe pak, djema, — dëgjuan zërin e tij.

Bujari kërceu anash. Kishte shkelur një gjarpër, ia kishte shtypur kokën, ndërsa bishti përdridhej rrëth qafës së këpucës në përpjekjet e fundit. Bujari ngriti këmbën dhe e shkundi duke e flakur gjarprin tutje, mbi një trung panje. Gjarpri desh të përdridhej përsëri sikur me atë përdredhje të gjen-te jetën, desh të shtrëngonte trungun po s'pati fuqi, nuk lëvizi veç gjysmën e trupit e mbeti ashtu, si një rrip mbi gjethet e vyshkura të panjës.

Midis gurëve e shkëmbinjve rriteshin pisha e panja, dëllinja e bushe. Bimësia pikëlonë me tërë blerimin e saj mbi bardhësinë shkëmbore e të çlodhët sytë.

— Kur të mbarojmë punë, do të pres një degë panje e do t'u bëj nga një lugë, — tha Gëzimi.

— Hë, hë, mos na gënje, — e ngau Kasoja.

— Bëj lugë, për merak, të shikoni se c'lugë do t'u bëj!

— S'i çibukun...

— Po çdo që na prenton, — ia priti Bujari.

Gëzimi rrudhi sytë e mbylli gojën. Kasoja kishte të drejtë, edhe Bujari kishte të drejtë, gjersa u kishëtë premtuar t'u bënte nga një çibuk prej bushi... E kishte në xhep copën e drurit e sa herë që e zinte me dorë thoshte me vete: «Sot do t'i jap fund, s'vete më, u turpërova». Tani që ia kujtuan s'ngrinte dot sytë të shikonte Kason. Po ç'desh që e hapi atë bisedë, ç'pati që i lehu goja!... Kapi një degë panje dhe e lëmoi me dorë.

— Këtë do ta pres, — tha.

Kasoja e Bujari qeshën me zë.

Pas pushimit fare të shkurtër që bënë nën hijen e një pishe, nga ku lugina dukej si në pëllëmbë të dorës, Kasoja brofi. Filloi përsëri ngjitja. Tani ndjekësit ecnin këmbadoras. Gëzimi gulçonte. I dukej sikur s'kishte të sosur ajo e përpjetë shkëmbore.

Punëtori operativ qe shtrirë barkas mbi një shkëmb e po përgjonte. Kur ndjeu shokët prapa shpinës tha:

— Arritëm!

— S'po shikoj asgjë, — foli Bujari.

— As unë, — tha Gëzimi.

Kasoja tregoi ca shkëmbinj mbi të cilët kishin mbirë shkurre bushi e mbylli sytë.

— Këtu do të ngrejmë pritën, do të zëmë vende në ata shkëmbinjtë, — tregoi me dorë. — Tani unë do të hedh një sy brenda, — tha e u nis.

«Burrë i çuditshëm ky Kasoja. Vepron i sigurt sikur ta dijë planin e banditëve... Po sikur të mos kthehen këtu, ku ta dish...»

— Banditet do të përpiqen të dalin nga rrithimi. Janë të regjur e dinakë. S'e ka keq Kasoja. Prita të

tilla si kjo jona, ka edhe në shtigje të tjera të këtij rajoni. Por një gjë është e sigurt, ata janë të bindur se shpella ku strehohen nuk është zbuluar, prandaj kush do të mundë të dalë nga rrëthimi, do të kthehet këtu, qoftë edhe për një ditë, sa të mbjellë idenë e zhdukjes e të marrë vjeten. Bishat në strofkë i lëpjinë plagët! — foli Bujari.

— Prandaj Kasoja ka besim t'i zërë të gjallë?

Kasoja qëndroi disa çaste përpara hyrjes së shpellës sa t'i mësosheshin sytë me errësirën. Shpella qe e ngushtë e në hyrje i ngjante një zgavre, ndërsa brenda sa vinte zgjerohej. Iu kujtua dimri i dyzete-katrës... Një e përqethur i përshkoi trupin dhe kujtimet e rrëmbyen. Në një farë vendi, trualli qe mbuluar me zhur të bardhë. Mori një dorë zhur në pëllëmbë. Këtu kishin varrosur Lekën. Iu kujtua ajo ditë kur erdhën e i nxorën koskat... *Ishte vjeshtë dhe dita qe e mugët, vesonte një shi i hollë e i ftohtë e qielli ngjyrë plumbi të dukej i rëndë dhe mytës...*

«Eh, o Lekë!» — psherëtiti Kasoja dhe shkeli lehtë mbi atë cop truall. Pastaj hapat e tij nxorën një tingull metalik sepse shkeli mbi një kuti konserve; kumbimi qe i thekshëm, por jehona befas u shua e shpella ra në heshtje, në atë heshtjen e gjatë e të zezë të shekuje. Në një kënd tjetër kishin shtruar degë bushi. Mbi truall kishte mbeturina ushqimesh. Diku, dëgjohej pik-piku i ujit që binte mbi një faqe guri.

Bujari u kap pas degës së një pishe e i dha trupit përpjetë duke kërcyer mbi një shkëmb të bardhë e të lëmuar si lëvozhgë veze, pas tij kërceu edhe Gëzimi e të dy qëndruan një copë herë në heshtje, përpara gojës së zezë të shpellës.

Më kot ishin munduar ta shquatin shpellën nga

larg. Ajo edhe këtu, nga trualli shkëmbor, mezi dukej. Të dilte befas përpara, pasi t'i kacavireshe shkëmbit të bardhë i cili i rrinte përpara si një mburojë e çeliktë.

— E kanë shkuar mirë atje brenda kodoshët, — u dëgjua zëri i Kasos që u shfaq përpara si hije. — Kanë ngrënë e kanë pirë sa kanë dashur. Edhe ujin e pas-kan brenda! Do të ketë plasur ndonjë damar andej nga fundi, ne atëherë hanim dëborë!

Shokët e shikonin me habi. Ai fliste me zë të thellë e të përbajtur, por në fytyrë kishte ndërruar, që bërë i butë e i zbetë dhe sytë të tejdukshëm. «Emocionet e shpellës, përmallimi për shokët e rënë, fijet e padukshme që lidhin njerëzit me vitet, me ngjarjet» — mendoi Bujari, e iu duk sikur Kasoja, në ato çaste kishte dëshirë të fliste, t'u tregonte për shokët e vjetër, për Lekën, për luftën, për gjithçka që dinte për ato bjeshkë... Po punëtori operativ nuk lëvizi as buzët, as dorën, as sytë, ai ndeјti një copë herë i hesh-
tur i humbur në kujtimet e veta.

Pozicionet që caktoi Kasoja, sajonin një trekëndësh e qenë të maskuara më së miri. Që andej mund të kontrolloje gjithçka përreth; luginën po se po, por edhe shpatet e maleve, shkarrëzimat, truallin shkëmbor e shpellën. Shkurt të gjitha rrugët e shtigjet që të shpinin në shpellë, ndërsa armiku nuk mund të të diktonë veçse po të të binte që sipër, por ai nuk kishte krahe. Kasoja mori frymë lirisht. Shikimin ia kishte hedhur luginës ndërsa pellgjet me ujë shkëlqenin me një dritë verbuese. Kasoja i njihte mirë ato shtigje, që regjur me prita, e njihte vendin me pëllëmbë edhe sikur t'ia lidhje sytë, ecte i sigurt,

— S, kusje strehun jfjet, supells u ka mpeta —

Buljati vëpshati atë puth de is imposante serurën

Dita po thyhej. Hijet vigane të maleve, me ato konture të zeza, sqë sa vinin bëheshin më të theksuarë, zunë ta errësojnë pjesë-pjesë luginën. Mbi malin e bardhë, në këmbët e të cilit ngrihej stani ku kishin fjetur një natë më parë, kishte rënë mjegull. Zbriste muzgu i mbrëmjes e gjithçka përreth hështte, asnjë zhurmë, asnjë piskamëbzogu, vetëm jehonase përroit që lëpinte pa pushim shpatet e grykat; i jepte pak jetë atij peisazhi.

Kasoja rrinte i menduar, struktur nën hijen e një shkëmbi midis dy shokëve. Kishte mbyllur sytë përgjysmë e sodiste luginën, ndërsa damari mbi tëmthin e majtë i rrihte e i nxinte, fytyra e gjerë me lëkurë të tendosur i dukej si e ngurosur dhe me dorën e majtë, prekte lehtë plagën e freskët që kishte nië faqe. Plaga i dhimbte e i digjte.

...Tre ditë më parë, forcat e ndjekjes, ishin ndeshur papritur me bandën e kriminelëve. Mundën të asgjësonin dy banditë, ndërsa kapobanda u zhduk...

Kjo ngjarje ia ndizte gjakun dhe shtrëngonte grushtet sa thonjtë i hynin në mish.

Hijet po zgjateshin e një mjegull e tejdukshme si avull po zbriste mbi luginë, ndërsa mbi majën e malit të bardhë vezullonte dëbora e përjetshme.

— Nuk do të flemë sonte, sic po duket puna. Më thotë mendja se kanë për t'u kthyer vonë, bredhin që të ngatërojnë gjurmët e të na mashtrojnë ne dhe shokët tanë...

— Mos ndoshta janë strehuar gjetkë, — tha Gëzimi i lëkundur.

— S'kanë strehim tjetër, shpella u ka mbetur, —
shtoi me vendosmëri Kasoja.

Bujari vështroi atë burrë që ia mbushte zemrën
me optimizëm. Kishte dëgjuar shumë për Kason, për
trimëritë e për vetmohimin e tij, prandaj edhe kishte
bindje te arsyetimet e tij, dhe kjo ndjenjë respek-
ti që kishte për Kason e bënte të heshtur e fjalë-
pakë.

Tjetër njeri qe Gëzimi, ai qe si ai mëzi sevzek, i
pamësuar. Ai vetëm dy herë e kishte nuhatur erën
e barutit, ama syri nuk i trembej e priste, si ai pë-
rroi i thatë, të vërvshonte me shiun e parë. Në fytyrën
zeshkane i ndritnin një palë sy të zinj me ca vetulla të
trasha e të zeza, si pendë korbi. Hundën e kishte si
sqep shkabe. Gëzimi qe i papërmajtur e kishte fjalë,
i pëlqente të bënte shaka me cilindo e të bëhej mik
që në takimin e parë.

Kason e kishte zënë uria ndaj i ftoi shokët.

— Hajde, merrni, — u tha duke ngulur majën e
thikës në kuti e duke nxjerrë një copë mish të rre-
thuar nga xhelatina e ndritshme.

Gëzimi rrudhi buzët padashur.

— S'ta mbush syrin, që po m'i mbledh buzët?

— Ç'të ma mbushë! Kjo sa të lyen buzët e të ndez
për ujë, — tha Gëzimi duke hapur çantën e vet.

— Domethënë hoqe dorë nga konserva, — pyeti
Bujari.

— Ç'tju bie më qafë.

Kasoja qeshi e i përkëdheli flokët Gëzimit.

— Ç'po më ngjall mallin e atij të shkretit djalë...
Edhe ai kështu bënte në sofër... Po të kishte rrojtur,
do të qe kaq, sa ti!

Kasoja e nisi fjalën me gëzim në buzë e më
vonë, sikur të qe penduar, e uli zërin, heshti befas

dhe i mbylli sytë fare. Nuk mund ta harronte të binrin, s'kishte ditë të mos kujtonte copa ngajeta e tij e shkurtër e sepse i dukej sikur gjëma kishte ndodhur dje. Gjithçka e kishte të freskët, ndonëse kishin kaluar pesë vjet, por sa herë që e kujtonte humbte në veten e tij e në ato çaste bëje mirë të mos i flisje.

— Kur ma sollën djalin në shtëpi, — e nisi sërisht fjalën punëtori operativ me zë si të shuar, — u hutova, s'më bëhej të besoja... Dy ditë s'vura gjë në gojë, as qaja dot; më vinte turp nga vetja... Kishte ca libra e ca fletore të shkollës, i merrja e i hapja përditë, ama nga shkolla nuk shkoja dot, më përpëlitez zemra. Po gruaja doli e fortë. Një herë s'i pashë lot në sy. Po s'ma merr mendja të mos ketë derdhur lot. Sigurisht që qante fshehtazi. «Nëna e ka dhimbjen më të hidhur», më tha një ditë.

Kasoja heshti përnjëherësh. Gëzimi e Bujari u panë në sy e ulën kokën. Ata e dinin që diversantët për t'u hakmarrë dhe për ta thyer Kason i kishin vrarë të birin.

— Kapobanda desh të më hiqte nga rruga ime, kujtoi se do të më linte qyq... Sa të marrë janë ata! Po unë luftoj për popullin tim, unë kam djem të tjerrë, kam Gëzimin, Bujarin, Pirron, kam Gjergjin, kam... Një togë me djem! — Kur mbaroi fjalën, damarë mbi tëmthiu fry e iu nxi. Vuri dorën mbi plagë. Dhimbja e pickonte në tru.

— Nuk kanë për të shpëtuar kësaj radhe, s'kanë ku të futen, do t'i fshijmë nga faqja e dheut, kini përtë parë, — foli përsëri Kasoja e u largua për në vendin e vet.

Ca yje zbardhnin në qiellin e zi. Punëtori operativ, pasi hetoi edhe një herë me dylbi luginën e shpatet përreth, ngriti jakën e xhupit e u ngjesh në pozicion. Në mendjen e tij, si në një mjegull nisën të luhaten kujtimet e largëta; fëmijëria e hidhur, lufta partizane, bandat e kriminelëve, djali... Ai lëviste ftyrën, buzët, sytë, duke kapur copa përfytyrimesh. Streha e kasketës i bënte hije e ia errësonët edhe më rrudhat e syve. Sytë i digjnin, qepallat i rëndonin se gjumi i sillej rrrotull. Pasi kaloi një valë kohë Kasoja filloj të dyshojë, po nuk desh të besonte se banditët s'do të dilnin këtej. Kur pa orën tre e gjysmë, tundi kokën, gogësiu e sepse ndjeu një drithmë në trup. Plaga në faqe i qe mpirë e nuk i ndiente më dhimbjet e saj. Nata pa gjumë e kishte lodhur pak por sa më tepër shtyhej ajo e afrontë dita aq më tepër e ndiente afshin e zjarrin që ia mbushte trupin e mendjen. Dyshimi po e brente e sa më tepër shkrihej mjegulla mbi luginë e sa më tepër merrnin dritë bjeshkët aq më tepër vrenjtej e tendosej ftyra e Kasos.

«S'kanë ku të futen. Në shpëtoftë ndonjë, këtej do të dalë... Kjo është qetësi e rreme, kjo s'më ve dot në gjumë» — mendonte. Kur mjegulla humbi në grykën e përroit, punëtori operativ ngriti dylbitë. Befas, në një kënd të luginës pa një gjë të zezë që lëvizte me plogështi. Ndërsa lart, në qiell, mbi luginë, vërtitej një shqiponjë, po atë çast, ndërsa po sodiste shqipen, kërceu përpjetë e zgjati veshët. Ishin shkrehur pushkë. Zbriti me shpejtësi te pozicioni i Bujarit.

— Pushkë ishin apo më bënë veshët?

— Pushkë!

— Zëri nuk erdhi nga lugina, o djalë, seç luan këtu, — pëshpëriti Kasoja i vrenjtur.

Batare të tjera u dëgjuan nga veriu.

— E shikon Bujar, po dalin prapa shpellës, unë po dal sipër, po i pres mbi shpellë, ju kini mendjen këtu.

Fjalët e fundit i tha në vrap e sipër e pas një çasti humbi nga sytë. Një kërkëllimë automatiku e mbushi luginën me jehonë. Tani s'kishte më asnje dyshim. Ndeshja kishte filluar por të shkrehurat vinnë nga drejtime të ndryshme. Bujari shkoi dorën mbi shpatullën e majtë dhe e pa se ishte qullur nga mjegulla e vesa e natës. Ndjeu se po mbërdhinte.

Hodhi sytë nga Gëzimi që po hetonte me dylbi nga veriu, prapa shpellës, kur befas dëgjoi një zhurmë. Mbajti frymën. Dega e pishës, ajo degë që kishte kapur Bujari kur u hodh në truallin shkëmbor, lëvizi e u hap. Bujari drejtoi armën. Pa një çast Gëzimin që lëvizi në pozicion por pastaj i humbi nga sytë, se ku u zhduk. Heshtje, por një heshtje e rremë... Gëzimi u duk përsëri tek po hiqej zvarrë, po herë i humbte nga sytë, herë i dilte. Më në fund e pa se si u ngrit, pa krahun e tij të gjatë lart në erë, pa edhe shkëlqimin e thikës që shtrëngonte në dorë.

Gëzimi e kishte diktuar më parë të panjohurin, por nuk kishte mundësi t'i jepte sinjal shokut. Ashtu si edhe Bujari, qe bërë gati të qëllonte, por papritur i qe kthyer mendja. Banditi iu duk i frikësuar e i paktë nga trupi dhe aty për aty vendosi të përdorë fuqinë e kraheve. Përse të zbulohej? Megjithatë nxori thikën. Krimineli dihaste e ngulte thonjtë në dhë, kacavirej me mundim, ndërsa Gëzimit po i hidhej zemra përpjetë, po i dridhej trupi, po i mjegulloheshin

sytë. Këtë ndjenjë s'e kishte provuar kurrë ndonjë herë. Ishte përballë një armiku që bënte përpjekjet e fundit pér të shpëtar kokën me çfarëdo mënyre e mjeti. Pér Gëzimin kjo qe një provë e madhe, ndoshta e panevojshme, por ai kishte vendosur, ndoshta i panjohuri qe vetë kapobanda?!

Qielli qe skuqur në lindje. Njeriun që ngjitej e kishte fare pranë. Një zë i brendshëm, i fuqishëm iu dük Gëzimit sikur i tha: «është provë e rëndë kjo» e trupi iu drodh. Po pér çudi ai zë i ngjau me zërin e Kasos, iu bë sikur iu faneps vetë Kasoja, rrumbullak; i fuqishëm, i regjur, me sytë gjysmë të myllur, me rrudhat e shumta rrëth syve dhe mblodhi të gjitha forcat e veta, ngriti dorën lart e iu hodh banditit përsipër si një shkëmb,

Bujari shtangu. Midis faqes së shkëmbit dhe trungut të pishës pa Gëzimin që kishte vënë poshtë armikun dhe po e kërcënonte me majën e thikës që ia kishte çikur në grykë. Fytyra e bardhë, si kartë, e banditit, me sytë e vegjël të zgurdulluar e pa ngjyrë, dukej si e vdekur. Nga veshi i djathtë gjer në qafë i rridhte një curril gjaku, ndërsa veshjen, një palë rroba malësori, e kishte të shqyer dhe në bark e në shpatull i dukej mishi i bardhë.

— Fol shpejt, hajt, ku janë të tjerët? — e pyeti Gëzimi duke kërcitur dhëmbët.

Por krimineli ishte mekur. Maja e thikës i dukej e ftohtë, si vdekja. S'kishte ndierë peshë aq të tmerrshme mbi trup, s'kishte parë njeri aq të fuqishëm... Dhe desh të rronte. Filloi të belbëzojë e të betohet se qe bërë pishman, mallkonte kabopandën e tha se ishte matur ta vriste, por... Buzët i dridheshin, fjalët i këputeshin në mes. Tha se ishte tmerruar e kishte parë vdekjen me sy, por i paskësh nxjerrë nga rrëthimi

një mik i kapobandës, një bari i pakënaqur që e urrente pushtetin popullor. Emrin nuk ia dinte.

Po kush mund ta besonte atë pleh.

— Mos, mos më vrisni, s'kam bërë gjë, më gënjyen, ai... — nisi t'i lidhë fjalët banditi.

— Ku janë të tjerët? — pyeti Bujari.

— Prapa. Po vijnë këtej.

— Sa janë?

— Dy. Të tjerë nuk di.

Pasi e çarmatosën e i lidhën gojën, duart e këmbët, e zvarritën, në një farë vendi të fshehur dhe e kthyen përbys. Bujari desh t'i bënte edhe ca pyetje, desh ta rrëmonte, por prapa tij kishte të tjerë, ata duhej të zinin vende e të kishin kujdes, ndërsa Kasoja s'po dukej. Krimineli mund të kishte gënjer për numrin. Sidoqoftë priteshin banditë të tjerë dhe Kasoja nuk mund të zbriste në truallin shkëmbor pa u diktuar. Bujarit iu rrëqeth trupi, i dukej sikur po u prishej plani... Këmbeu një shikim të shpejtë me Gëzimin. S'dinin s'i të bënин. S'i ta lajmëronin Kason!? Befas, nga veriu, në pozicionin e Gëzimit u panë dy banditë tek po kacavirreshin faqes shkëmbore të shpellës. Bujari sa nuk klithi e u rrotullua vetëtimthi në pozicion. U bë gati të hapë zjarr, por shfaqja e banditit të tretë e hodhi përpjetë. Robi i paskësh gënjer. Vuri dorën mbi shulin e automatikut, e lëmoi, picërrroi sytë e hapi zjarr.

Gjëmimi i përroit që përcillte jehonën e automatikëve të Bujarit e Gëzimit, e lëndoi pak Kason. Nuk që gënjer kurrë gjer atë ditë. Intuita e tij prej bariu

e ndjekësi kishte qenë gjithmonë e saktë, ndërsa sot banditët kishin rrahir shtigje të tjera që të arrinin në shpellë. U rras pas një zgërbonje, rrudhi sytë që i digjinin nga pagjumësia e ndoqi me vëmendje fishkëllimën e plumbave.

Papandehur, kishin rënë midis dy zjarreve! Ndjeu një shtrëngim të fortë në krahëror. Ata, shokët e tij, po luftonin. Nguli thonjtë në dhe e u zembraps që të dilte nga zona e zjarrit por ishte i zbuluar. Ç'të bënte? Të fillonte luftë atje s'kishte kuptim. Dhe në qoftë se kishte shpëtar para tërë ditëve kjo qe një rastësi dhes'do të thoshte se mund të shpëtonte gjithnjë. Një plumb i përzhitit lëkurën e veshit. Por gjakftohtë si gjithnjë, me atë shije të athtë në gojë, që provonte sa herë ndodhej përpëra vdekjes, hapi zjarr të dendur mbi banditët e duke gërryer tokën me këmbë e duar, u hoq së praphi pér të zënë vend prapa një shkëmbi të bardhë. Kërceu me një shkathësi të habitshme e hodhi një bombë. Bëri edhe një kërcim tjetër e ngjeshi kokën prapa një guri që dukej si një thes. Prapa shpinës së Kasos zbriste përrroi ndërsa armiqtë kishin dalë nga ana e luginës ashtu siç nuk priteshin. Nuk ishin më tepër se tridhjetë metra larg e shtinin që prapa një trungu të rrëzuar.

Dukja e banditëve nga drejtime të ndryshme shpjegohej me faktin se kishin dalë nga rrëthimi pjesë-pjesë pa arritur të bënin lidhje. Secili kishte vapuar sipas mendjes pér të shpëtar kokën.

Nuk dihej se sa do të ishin ata që kishin dalë nga rrëthimi, sidoqoftë ata do të ishin të rraskapur, pa fishekë e pa bukë, prandaj s'kishin pér të rezistuar shumë. Prapa shpinës së Kasos luftonin Bujari me Gëzimin, e zhurmën e luftës e përcillnin shpatet drejt pë-

froit, ndërsa punëtori operativ e kishte mendjen te kapobanda e nuk e merrete dot me mend se ç'bëhej nje të, kishte mbetur apo ishte duke luftuar. Sepse i qe ngulitur në tru se ai kishte dalë nga rrethimi.

Banditet po këmbëngulnin shumë në qëndresën e tyre megjithëse trungu i rrëzuar po grihej në cifla nga plumbat e Kasos dhe ata nuk bënин asnje hap prapa. Por edhe guri prapa të cilil mbrohej punëtori operativ, po thërrmohej. Diku, pranë, fare pranë, qe një ledh i ngrënë nga rrëkeja, por që të arrije atje qe krejt e pamundur. Ledhi kishte një pozicion shumë të përshtatshëm dhe Kasos atje i punonte mendja. Një çast, kur armiqtë e dendësan zjarrin e ai qe i detyruar të rrasej fort pas gurit, bëri gati granadat. Nuk e duronte dot më atë yetëmbrojtje, nuk mund të pajtohej me të dhe sulmin mbi armikun nuk e hiqte nga mendja.

«Nuk e nxij faqen unë!»

Zëri i armëve të shokëve të tij e ftonte për sulm. «Hajt se një nga një do t'u qërojmë» — sokelliu Kasoja dhe flaku një bombë.

Plasja qe aq e fuqishme sa e habiti edhe vetë Kason, pastaj pa se si fluturuau në erë copa druri, plisa dheu e gurë, dëgjoi edhe një klithmë e duke u sulur përpara, nëpër tym, e kositi pozicionin e armikut duke harxhuar një karikator fishekë. Trungu, prapa të cilil luftonin armiqtë pak më parë, kishte luajtur nga vendi nga vala e plasjes, ndërsa njëri nga armiqtë kishte rënë më kurriz, krahëhapur. Pranë të vdekurit ishin dy automatikë, kuptohej se pushkën e dytë e kishte braktisur ndonjë tjetër që kishte mundur të zhdukej. Punëtori operativ hetoi terrenin përreth. «Ku do të jetë futur? Në mos është gremisur në përrua. Me siguri do të jetë këtu rrotull e mund të hapë luftë

përsëri. Do të ketë revole, thikë e ndofta edhe bomba! Po ku je, o i mallkuar pse s'qëllon?» — pëshpëriti Kasoja e u hoq zvarrë të shihte pérroin. Por atë çast, diçka u shemb mbi të e një e therur e hidhur ia përshkoi të gjithë trupin. U rrotullua me mundim, zgjati duart, preku një send të butë e të qullët, shikimi iu turbullua e një tis i kuq gjaku iu bë pérpara. I dukej sikur kish-te rënë në një llucë balte e s'po e kuptonte nëse po shpëtonte prej saj apo po fundosej.

Gëzimi kishte ndërruar pozicion. Qe spostuar pak më pérpara, ndërsa Bujari ishte po në vendin e parë. Kishin mbetur edhe dy banditë që tentonin të dilnin nga zjarri, por nuk prapseshin dot.

— Dorëzohuni! — thirri Bujari.

— Dilni në shesh, or tradhtarë! — plotësoi Gëzimi.

Pas një heshtjeje të shkurtër njeri nga banditet, ngriti duart lart e doli nga pozicioni, por befas u këput më dysh e ra me kokë poshtë duke ngulur gish-tat në dhë. E kishin qëlluar që prapa!

— Shiko se si po e shqyeyjnë njëri-tjetrin! Dil, ore, në shesh në ta mban, — thirri Gëzimi.

Por banditi s'jepej. Ai zgjaste turirin si ketër në-për gurët dhe lëshonte breshëri plumbash. Bujari, si i dha shenjë Gëzimit që të mos e ndalte zjarrin, doli nga pozicioni. Kishte vendosur t'i merrte krahët banditit. Donte ta qéronte hesapin me të që t'i vinin në ndihmë përgjegjësit të grupit. Ai duhej asgjësuar me çdo kusht, e i duhej shkuar në ndihmë Kasos. «Çudi, ku humbi Kasoja?! Tani nuk dëgjohet më as luftë andej!» Bujarin po e brenin mendime të liga. «Pse

s'po qëllon Kasoja?» Dhe hiqej zvarrë nga krahu i majtë i banditit.

Bujari kishte përparuar shumë e më tej nuk mund të shkonte se do të diktohej, por aty ku ishte nuk shikonte asgjë. Mos kishte ndërruar pozicion krimineli? Përgjoi një copë herë e bëri përparrë edhe disa metra. Në këtë çast pa banditin që po zmbrapsej.

«Do të dalë nga lufta, do të ikë, do të shpëtojë!»

— Ndal! — thirri Bujari.

Banditi u vërtit si gjarpër e ktheu armën në drejtim të Bujarit. Por ishte vonë. Bujari e kishte nën kthetra.

Nuk dëgjohej më asnjë e shtënë pushke. Me mendje të lodhur e të drobitur, punëtori operativ nuk dëgjonte asgjë, nuk shikonte asgjë, aq sa lufta që ishte bërë pak më parë i dukej si një ëndërr. Nga një vegim binte në tjetrin. *Iu bë se po kthehej vonë në shtëpi, hëna e plotë zbardhë, në një kopësht iu turr një qen por kur i ndjeu erën u largua, ai shkoi drejt shtëpisë...*

Gjoksi i gufone. Trupi i qe shembur përtokë. Një fytyrë e shëmtuar, e egër, me sy të kuq e gojë të shtrembër i rrinte përsipër... Njeriu që e kishte bënë poshtë qe kapobanda!

Tradhtari hungërinte dhe përpiquej ta mposhte punëtorin operativ. Thika e përgjakur që sapo kishte dalë nga shpatulla e ndjekësit pikonte gjak dhe kërkonte gjak të ri. Kasoja tendosi muskujt. Tani nuk e ndiente shpatullën e shpuar, as dhimbjen në plagë e

faqes, por ishte zënë ngushtë, nuk e kishte parë veten aq në zor ndonjëherë.

«O jetë, o vdekje!» — mendoi e i dha trupit me të gjithë fuqinë që i kishte mbetur. Ishte përpjekja e fundit, britma e fundit, ndeshja e fundit. Armiku u përmbyss, thika i shpëtoi nga dora por nuk u shkëput dot nga trupi i Kasos. U kacafytën, u rrokullisën. Kapobanda hungërinte, kafshonte, përpélitej e ia ngulte thonjtë në mish Kasos, donte jetën e tij, donte ta shuan te fare atë shtëpi, të mos linte këmbë mashkulli. Emri i Kasos qe bëre i dëgjuar në bandat e kriminelëve e ai njeri u kallte tmerrin. Ta vinin në hell e ta piqnin të gjallë apo diçka tjetër më të tmerrshme e s'do të kishin të ngopur. Por koska e Kasos të zihej në grykë. Kapobandën e kishte pushtuar tmerri, e kishte pasur nën vete dhe s'ia kishte arritur qëllimit. Kapobanda po shkallonte.

Përleshja ndodhi në buzë të përroit, e tek po rrokullisej me egërsi i kacafytur me njeriun që urrente për vdekje, u bind se s'kishte asnjë shpresë shpëtimi e se vdekja e sigurt e priste poshtë te shkëmbinjtë apo në pellgun e thellë të përroit. Nuk e kujtonte se sa herë u shemb e u ngjesh mbi gurët e ftohtë që e prisin trupin e tij me indiferentizëm, nuk e kuptoi sa herë u ndodh sipër e sa herë poshtë Kapobandës. Të dy mbérthyer me njëri-tjetrin rrokulliseshin. Dhe rrokullisja s'kishte të mbaruar, humnera i priste poshtë. Punëtori operativ bëri një përpjekje tjetër të fuqishme për t'u shkëputur nga armiku. Nuk donte të vdiste me të, desh të ishte sa më larg tij, por ky mundim i vajti kot. Kopabanda nuk e lëshonte, si të kishte vdekur e duart t'i kishin ngrirë mbi trupin e Kasos...

Mbi shpinë ndjeu një kërcitje të fortë, një krah

iu përdrodh nën peshën e trupit si plumb të banditit, por ato goditje qenë të shurdhra, pa dhimbje, pasi gjithçka i qe mpirë, veç trurit. Një çast iu duk sikur u lehtësua nga ajo peshë që e shpinte drejt vdekjes, por sytë nuk i shihnin, shikimin e kishte të mjegulluar. Befas një valë shkumbë e bardhë, si borë, u ngrit lart e u përplas mbi shkëmb. Atë çast punëtori operativ u shkëput nga dara e armikut e ndërsa kapobanda shtrëngonte në duart rreckat e përgjakura të këmishës së Kasos, punëtori operativ kërceu mbi të. Ky qe çasti i fundit, vdekja kishte hapur krahët, por Kasoja ia kishte përfshirë qafën me të dyja duart e ia kishte përplasur kokën në shkëmb.

Punëtori operativ, ndjeu dalngadalë se si u rën-
dua trupi i kriminelit e se si shkau e u zhyt në pellg
me gojë hapur e me sytë e kërcyer jashtë, më të kuq
se kurrë. Pastaj nuk ndjeu asgjë, nuk pa asgjë, gjith-
çka përreth iu bë e errët, pa dritë, e ftohtë dhe e hesh-
tur. Nuk e kuptoi sa zgjati ajo mpirje, veç kur zunë
t'i buçasin veshët nga shungullima e përroit e kur
mjegulla u shpërndë nga sytë e tij, pa shkëlqimin e
diellit mbi shkumbën e bardhë, pa trupin e kapoban-
dës gjysmë-në ujë, pa edhe Bujarin me Gëzimin që
po e ngrinin në krahë.

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Njeriu me fener	3
Një ditë dimri	15
Lëkundje	24
Mekaniku i turnit	34
Ngjarje në kantier	45
Vajza jonë	55
Prita në shpellë	67